# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6024
E premte, 13 mars 2020
çmimi 0.40 €


## Zgjedhjet në Podujevë nuk shtyhen
FAQE 7




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


INSTITUCIONET E KOSOVËS JANË MOBILIZUAR NDAJ MANIPULIMIT TË RRITJES SË ÇMIMEVE NGA ANA E MARKETEVE FAQE 4-5

# KORONAVIRUSI SHTYN QYTETARËT TË FURNIZOHEN ME PRODUKTE, MARKETET SHTRENJTOJNË MALLRAT





Në Kosovë ende nuk është shënuar asnjë rast i konfirmuar me koronavirus, por qytetarët të mërkurën dhe të enjten kanë vërshuar marketet për t'u furnizuar me ushqime e gjësende të tjera në rast se duhet të izolohen nëpër shtëpitë e tyre. Duke e parë këtë reagim të qytetarëve, shumica e marketeve të mëdha kanë ngritur çmimet. Ndaj ngritjes së çmimeve ka pasur reagim nga institucionet e vendit dhe shoqëria civile

ËSHTË MBAJTUR "KONFERENCA E UNITETIT PËR DIALOG" ME PARTITË PARLAMENTARE

## Opozita kërkon që në dialog të ecet me Amerikën



Subjektet politike opozitare kanë shprehur qëndrimin e tyre që Kosova në procesin e dialogut me Serbinë të ecë bashkë me ShBA-në. Në takimin e parë të "Konferencës së unitetit për dialog", të thirrur nga lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, liderët e këtyre partive kanë shprehur dëshirën për unifikim të qëndrimeve për këtë çështje, por nuk kanë arritur ndonjë qëndrim të përbashkët. Ata i kanë ftuar partitë në pushtet që të reflektojnë në raport me marrëveshjen finale të dialogut Kosovë - Serb



## Kosova shton masat mbrojtëse ndaj koronavirusit
FAQE 4-5

## OPINION

### NDËRMJETËSIM APO DIRIGJIM? F. 11



Ismajl KURTESHI

### KOSOVA PARA VENDIMMARRJES QË TEJKALON KAPRICIET E BRENDSHME F. 11



Nga Mehmet PRISHTINA

## AKTUALE

### PRESIDENTI THAÇI DEKORON ME 'URDHRIN E LIRISË' VEPRIMTARIN SADIK ZEQIRI F. 3



## EKONOMI

### BERZH-i OFRON PËRKRAHJE NË PROJEKTET ENERGJETIKE F. 8

### NGA SOT PEZULLOHEN FLUTURIMET NGA GJERMANIA, FRANCA, ZVICRA E ITALIA DREJT KOSOVËS F. 8

## KULTURË

### KOMUNITETET NË KOSOVË PËR RUAJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE F. 6


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net I www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# DASh: Korrupsion i lartë dhe gjyqësi e kufizuar në Maqedoninë e Veriut

**Në Raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit për të drejtat e njeriut në botë për vitin 2019, Maqedonia e Veriut konsiderohet si vend me prani të lartë të korrupsionit, pavarësi të kufizuar në gjyqësor si dhe Këshill Gjyqësor të politizuar dhe të financuar në mënyrë joadekuate**



Alastair Grant / POOL (AFP)

SHKUP, 12 MARS - Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për të drejtat e njeriut në botë për vitin 2019, ka konstatuar se në Maqedoninë e Veriut ka prani të lartë të korrupsionit, pavarësi të kufizuar në gjyqësor si dhe këshill gjyqësor të politizuar dhe të financuar në mënyrë joadekuate. Raporti, gjithashtu, konstaton gjendje jo të mirë dhe presione ndaj komunitetit LGBT.

Në vend janë shqiptuar dënime për korrupsion kundër zyrtarëve, por megjithëse qeveria në përgjithësi e zbaton ligjin, ka ende raste të zyrtarëve të përfshirë në korrupsion, thuhet në raport. "Qeveria ka bërë përparim në respektimin e lirisë së medies dhe lirisë së fjalës, por problemet mbeten, përfshirë pavarësinë e dobët të medieve, dhunën dhe kërcënimet ndaj gazetarëve", thekson raporti i Departamentit amerikan të Shtetit, ka njoftuar rfe.

Nga qeveria nuk kanë komentuar ende raportin, por kanë theksuar përkushtimin për të vazhduar siç thonë me masat për ngritjen e sistemit gjyqësor duke përmendur miratimin e Ligjit për prokurorinë publike, shkarkimin nga detyra të ish-kryetarit të Gjykatës Supreme, vazhdimin e lëndëve të prokurorisë speciale, e masa tjera.

Por, VMRO DPMNE-ja opozitare përmes një njoftimi theksoi se "raporti i DASH-it është edhe një fakt për dështimet e qeverisë, korrupsionin e lartë në radhët e saj, rastin "Reketi" ku janë përfshirë edhe zyrtarë të lartë".

Ekspertët ndërkohë thonë se raporti pasqyron gjendjen reale në vend, duke shprehur pakënaqësi për siç theksojnë mungesën e masave serioze në luftën kundër luftimin të korrupsionit dhe krimit të organizuar. "Ne nuk kemi asnjë aktivitet efikas të ndonjë organi për përballje efikase me korrupsionin. Edhe rastet që janë ndërmarrë nga organet e ndjekjes, prokurorët nuk duan t'i procedojnë pasi atje kemi ndikime të fuqishme të lobeve të ndryshme politike. Kemi dështime edhe në punën e Komisionit Antikorrupsion, organ që nuk kanë as kushtet elementare për punë, e as të zbatojnë ligjin e ri", thonë ata. "Qeveria nuk ka asnjë politikë kundër korrupsionit, nuk ka madje as ekip këshilltarësh të korrupsionit. Le të thonë sa të duan se po punojnë kundër korrupsionit, por rezultatet tregojnë të kundërtën", thotë Sllagjana Taseva, eksperte e antikorrupsionit.

Ajo thotë se ky raport gjithsesi se do të reflektohet edhe në procesin euro-integrues, dhe se ky raport sipas saj, është hartuar edhe në bazë të raporteve kritikuese që kanë dalë nga institucionet e Bashkimit Evropian. "Kur të fillojë procesi i integrimit evropian, nëse fillon ndonjëherë, në sipërfaqe do të dalin shumë lëshime që kemi. Kemi një Prokurori që aspak nuk është e pavarur, punësimet janë partiake, në zgjedhje kemi lëshime, kurdisje tenderësh, punë joefikase të institucioneve. Do të jetë mirë për vendin nëse fillojnë bisedimet pasi atëherë besoj se do të kemi transparencë. Do të ketë kontroll më të rreptë dhe do të dimë se çfarë po ndodhë", thotë Taseva.

Maqedonia e Veriut në raportin e fundit të Komisionit Evropian është lavdëruar për reformat që ka ndërmarrë, megjithëse ka theksuar se ende ka shumë punë për të bërë në realizimin e reformave, në veçanti në administratën publike, në gjyqësor si dhe në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

# Anulohen tubimet parazgjedhore në Maqedoninë e Veriut

SHKUP, 12 MARS - Liderët e partive politike në Maqedoninë e Veriut janë pajtuar për t'i anuluar të gjithë aktivitetet politike deri më 24 mars, ndërsa bënë thirrje për respektimin e të gjitha rekomandimeve të komitetit shtetëror për mbrojtje nga koronavirusi i ri.

Takimi u thirr nga kryeministri, Oliveri Spasovski për t'i koordinuar masat para se vendi të nisë fushatën elektorale pas dy javësh për zgjedhjet parlamentare, më 12 prill. "Më e rëndësishme, është shëndeti i qytetarëve. Në këtë drejtim janë edhe rekomandimet për tubimet dhe kafiteritë. Mbeten në fuqi ndalesat për mësim për nxënësit dhe studentët. Konfirmuam se fushata do të jetë në pajtim me rekomandimet e Shtabit të krizës dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe të gjithë e kemi për obligim që t'i respektojmë. Apeloj deri te qytetarët që në maksimum të respektohen këto rekomandime", ka deklaruar kryetari i LSDM-së, ish-kryeministri, Zoran Zaevi.

Kryetari i VMRO DPMNE-së, Hristijan Mickovski tha se në këtë takim nuk është biseduar për shtyrjen e zgjedhjeve por anulimin e tubimeve gjatë fushatës zgjedhore. "Nuk është shqyrtuar mundësia për shtyrjen e zgjedhjeve. Ajo për çfarë kemi biseduar ka të bëjë kryesisht me fushatën zgjedhore në të cilën nuk do të ketë mitingje partiake. Do të zhvillojmë fushatë alternative, do të shkojmë derë më derë, do të organizojmë konferenca për mediat ndërsa do të shfrytëzojmë edhe rrjetet sociale për përcjelljen e qëndrimeve partiake", ka deklaruar kryetari i opozitës maqedonase, Hristijan Mickovski.



Kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, tha se beson që nuk do të ketë përhapje të koronavirusit, por kjo sipas tij nuk nënkupton që institucionet të mos marrin masa parandaluese. "Të gjithë u dakorduam që këto masa duhet të përforcohen, pavarësisht se vendi ynë nuk është i rrezikuar nga ky virus. Megjithatë, shteti obligohet që të marrë masa që ky virus të mos përhapet. Sa u përket zgjedhjeve do të respektohen rekomandimet që do të dalin nga organet kompetente, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Grupi i krizës", tha Ali Ahmeti, kryetar i BDI-së.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Është mbajtur "Konferenca e unitetit për dialog" me partitë parlamentare

# Opozita kërkon që në dialog të ecet me Amerikën

Subjektet politike opozitare kanë shprehur qëndrimin e tyre që Kosova në procesin e dialogut me Serbinë të ecë bashkë me ShBA-në. Në takimin e parë të "Konferencës së unitetit për dialog", të thirrur nga lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, liderët e këtyre partive kanë shprehur dëshirën për unifikim të qëndrimeve për këtë çështje, por nuk kanë arritur ndonjë qëndrim të përbashkët. Ata i kanë ftuar partitë në pushtet që të reflektojnë në raport me marrëveshjen finale të dialogut Kosovë - Serbi



Muhamet KOCI

PRISHTINË, 12 MARS - Në takimin e parë të "Konferencës së unitetit për dialog", të thirrur nga lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, subjektet politike opozitare kanë shprehur dëshirë që të ketë përafrim qëndrimesh rreth dialogut Kosovë - Serbi, por nuk kanë arritur në ndonjë konkluzion të përbashkët.
Liderët e këtyre subjekte politike kanë kërkuar që Kosova në këtë proces të ecë përkrah Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Nikoqiri i kësaj konference, ish-kryeministri Ramush Haradinaj, pas takimit ka thënë se vetëm mosuniteti dëmton raportet e Kosovës me ShBA-në. "Qëndrimi im është që ne duhet të ecim me Amerikën për një marrëveshje përfundimtare. Çështja e taksës, qëndrimi ynë dhe i Aleancës është që taksa të mbetet në fuqi deri në njohje. Ishte një diskutim i hapur, bukur i sinqertë. Edhe pse sot nuk kemi konkluzione të qarta, është vërejtur një dëshirë për afrim qëndrimesh. LDK-ja ka kërkuar falje për mospjesëmarrje, por ka propozuar që të kemi një takim bilateral në ditët që vijnë", ka deklaruar Haradinaj.
Ai ka treguar se taksa po vazhdon t'i ndajë partitë. "Ka qëndrime të ndryshme sa i përket veprimit me taksën. Jam i hapur për konsultime të ndërsjella. Taksa nuk është menduar të jetë e përjetshme, por deri në njohje. Mendoj se ka qenë gabim ofertimi i hershëm për heqje ose për reciprocitet. Mendoj se është dashur të negociohet koha, që të hiqet në kohën e njëjtë me kontratën finale. Nëse ka vullnet në të ardhmen mund të ketë edhe një qëndrim më të qartë. Marrëdhëniet me ShBA-në i dëmton mosuniteti ynë", ka thënë ai.
Lideri i PDK-së, Kadri Veseli, e ka ftuar qeverinë që të reflektojë në raport me opozitën dhe ShBA-në. "Nuk e di a është problem taksa, a është problem mungesa e kësaj qeverie për t'u ballafaquar nga qëndrimet që i kanë të ndara mes vete. Nuk është me rëndësi cili pozicion është i partive opozitare, për arsye se ne nuk marrim tani më vendim. Rrethanat janë shumë të kristalta, qoftë nga BE-ja, qoftë nga ShBA-ja. Pushteti duhet të reflektojë me opozitën, jo për ta mposhtur opozitën. Është një përshtypje se është një ide se si të na mposhtin", ka thënë Veseli.
Ai ka pasur edhe një mesazh për pushtetin. "Pushteti më tepër e ka në fokus betejën politike për të na mposhtur neve sesa që Kosova të dalë mirë. Duhet konsensus, duhet bashkëpunim. Ne nuk mund si opozitë t'i japim askujt mandat e as ta këshillojmë Trumpin se kë ta ftojë në takime. Kam një mesazh për pushtetin: 'ne nuk jemi armiq, zgjedhjet kanë përfunduar", është shprehur Veseli.
Kurse kreu i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se në këtë takim janë shprehur qëndrimet që janë të njohura nga secila parti. "Unë shfrytëzova rastin edhe në takim që t'u them kolegëve çka po shoh sot është ajo çka ka ndodhur para dy vjetëve. Tash është kthyer në një situatë edhe më alarmante, një përplasje institucionale. Dikur kryeministri me presidentin, ndërsa sot kemi kryeministrin me presidentin, por edhe kryetarja e Kuvendit. Kanë një përplasje institucionale më tepër për protagonizëm sesa për esencë", ka deklaruar Limaj.
Ai ka deklaruar se në mes të liderëve në vend ka përplasje të egove, duke shtuar se kjo situatë do t'i kushtojë Kosovës. "Ma tepër ka përplasje të egove të tyres sesa në përmbajtje të shqetësimit për interesin e vendit dhe ne si Nismë ju thamë se nuk duam që të marrim pjesë në përplasje të tillë. Dikur jemi munduar ta eliminojmë përplasjen mes kryeministrit dhe presidentit, kjo po vazhdon. Kjo nuk i shërben vendit. Thjesht sot vendi ynë është me rrezikqe për prishje të marrëdhënieve qoftë me BE-në qoftë me Amerikën. Arsyeja është njëfarë gare e pakuptimtë për protagonizëm që do ta dëmtojë Kosovën", është shprehur Limaj.
Në këtë konferencë ka marrë pjesë edhe kryetari i AKR-së, Behgjet Pacolli, i cili ka bërë thirrje për unitet rreth dialogut. "Ne duhet të kemi unitet. Ne duhet t'i lëmë mënjanë dallimet tona dhe t'i bashkojmë forcat për qëllimin e madh të ngritjes së flamurit të Kosovës në OKB. AKR-ja do ta luajë rolin e saj konstruktiv dhe mbështetës për unitetin e skenës politike. Por uniteti diskutohet mes nesh dhe jo në media sociale. Të lëmë mënjanë protagonizmin, t'i lëmë mënjanë egot dhe të krijojmë kushte për bashkëpunim konstruktiv në të mirën e vendit", ka thënë Pacolli.
Ai ka deklaruar se Qeveria e Kosovës duhet ta heqë taksën ndaj mallrave serbe ashtu siç po kërkon ShBA-ja. "Të gjithë duhet ta mbështesim nismën amerikane për ta ndërmjetësuar dialogun Kosovë - Serbi. Nëse kemi frikë nga Amerika, na ka marrë pusi, kush është ai vend që na mbron nëse jo Amerika? Pra, pika e parë e unitetit është ta mbështesim lidershipin amerikan. Interesat amerikane janë interesat tona. Nuk ka këtu dallime", ka thënë Pacolli.
Në këtë konferencë nuk kanë marrë pjesë LDK-ja dhe Lista Serbe. Nga Lëvizja Vetëvendosje ka marrë pjesë deputeti Liburn Aliu.

# Presidenti Thaçi dekoron me 'Urdhrin e Lirisë' veprimtarin Sadik Zeqiri



PRISHTINË, 12 MARS (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka dekoruar me 'Urdhrin e Lirisë' veprimtarin e çështjes kombëtare, Sadik Zeqiri. Thaçi përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se Zeqiri sa ishte student iu bashkua luftës së UÇK-së, duke dhënë kontribut të çmuar për lirinë tonë. "Veprimtarin e zellshëm të çështjes kombëtare, Sadik Zeqirin, sot e dekorova me 'Urdhrin e Lirisë'. Ai si student iu bashkua luftës së UÇK-së, duke dhënë kontribut të çmuar për lirinë tonë. Është edhe i burgosur politik, i plagosur dhe i mbijetuar i masakrës në Burgun e Dubravës", ka shkruar presidenti Thaçi.

PREJ 82 PACIENTËVE TË TESTUAR PËR KORONAVIRUS NË KOSOVË TË GJITHË REZULTOJNË NEGATIVË

# KOSOVA SHTON MASAT MBRO

Deri të enjten në Kosovë janë testuar 82 raste për koronavirus dhe të gjitha kanë rezultuar negative, kurse 10 mostra të tjera që janë testuar gjatë ditës së enjte janë në pritje të rezultateve. Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka kërkuar nga qytetarët që angazhimin e institucioneve dhe masat e ndërmarra nga qeveria t'i kuptojnë vetëm si kujdes i shtuar për shëndetin publik. Ai ka thënë se pjesëmarrja e qytetarëve për zbatimin e këtyre masave është po aq e rëndësishme sa edhe e institucioneve

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 12 MARS - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka bërë me dije të enjten se deri tash në Kosovë nuk është konfirmuar ndonjë rast me koronavirus Covid-19.
Në një konferencë për media, ai ka thënë se masat e marra nga Qeveria e Kosovës kanë për qëllim parandalimin e përhapjes së koronavirusit dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës. "Në këtë kuadër, përveç këtyre masave të një dite më parë, sot të gjitha institucioneve shëndetësore publike dhe private do t'u dërgohet Qarkorja Informative me rekomandime specifike që kanë për qëllim mbrojtjen e stafit shëndetësor, sigurinë e pacientëve dhe qytetarëve që kërkojnë shërbime në këto institucione", ka thënë Vitia.
Ai ka vlerësuar se sëmundjet janë pjesë e përditshmërisë, por ato marrin një dimension tjetër kur shfaqen për herë të parë. Sipas tij, bëhet fjalë për një virus i cili është trajtuar në shtetet e prekura dhe praktika ka dëshmuar edhe për shërimin e tij. Ministri Vitia ka kërkuar nga qytetarët që angazhimin e institucioneve dhe masat e ndërmarra t;i kuptojnë vetëm si kujdes i shtuar për shëndetin publik, gjë që ka sjellë edhe rezultatin që, sipas të dhënave të OBSh-së, Kosova të bëjë pjesë në mesin e vendeve me rrezik të ulët në raport me koronavirusin Covid 19.
Gjithashtu, Vitia ka apeluar te qytetarët që, përveç masave që janë ndërmarrë që prej janarit kundër koronavirusit Covid 19, të kenë mirëkuptim për disa rekomandime të tjera të cilat kanë dalë nga propozimet e profesionistëve shëndetësorë dhe janë të nevojshme në situata emergjente. "Këto masa janë po aq të rëndësishme sa edhe vendimet e marra nga qeveria dhe rekomandimet që u janë dërguar institucioneve shëndetësore", ka thënë ai, duke falënderuar personelin shëndetësor për punën dhe angazhimin e tyre.
Ai ka treguar se janë bërë përgatitjet dhe së shpejti




## Rekomandimet për qytetarët:

1. Individët të praktikojnë masa parandaluese të përditshme, si larja e shpeshtë e duarve, qëndrimi në shtëpi kur janë të sëmurë dhe mbajtje e higjienës respiratore (mbulimi me gropëzën e bërrylit gjatë kollitjes dhe teshtitjeve).
2. Të mbahet të paktën 1 metër distancë midis vetes dhe kujtdo që kollitet ose teshtin.
3. Të shmanget frekuentimi në qendra tregtare, kafiteri, restorante dhe klube të natës.
4. Të ndalohet veprimtaria e restoranteve dhe klubeve të natës pas orës 23:00.
5. Objektet hotelierike, restorantet, kafiteritë të mbajnë distancë strikte së paku mbi 1,5 metra në mes tavolinave dhe së paku 1 metër distancë të klientëve mes veti.
6. Ndërmarrjet dhe kompanitë të hartojnë plane për të punuar nga shtëpia për aq sa është e mundur.
7. Personat e rritur dhe kategoritë me rrezik të lartë të qytetarëve me sëmundje kronike, ta rrallojnë lëvizjen dhe të shmangin transportin publik.
8. Rekomandohet shmangie e udhëtimeve në vende të cilat janë me rrezik të lartë dhe të mesëm, në përputhje me listën e Organizatës Botërore Shëndetësore.

## Ndërpritet procesi edukativo-arsimor i kadetëve të policisë

PRISHTINË, 12 MARS - Për shkak të marrjes së masave parandaluese për t'u mbrojtur nga koronavirusi, të enjten në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike ndërpritet procesi edukativo-arsimor i kadetëve të Policisë së Kosovës dhe studentëve të Fakultetit të Sigurisë Publike.
Kadetët e Policisë së Kosovës në paradën e mëngjesit të ditës së enjte u njoftuan nga drejtori i përgjithshëm i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, Ismail Smakiqi, për ndërprerjen e trajnimit të Programit Profesional si dhe u kërkua nga ta që t'i respektojnë udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me masat preventive kundër koronavirusit. "Kjo masë u mor në përputhje me vendimin e Qeverisë së Kosovës nr .01/07 të datës 11.03.2020, pikës 1.1 të këtij vendimi ku, nder të tjera, thuhet: 'Ndërprerja e procesit edukativo-arsimor të institucioneve arsimore publike dhe private në të gjitha nivelet deri më 27 mars 2020'. Bazuar në këtë vendim nga sot u ndërpre procesi mësimor i kadetëve, studentëve, po ashtu pezullohen të gjitha aktivitetet të cilat janë në fushëveprimtarinë e Akademisë", është thënë në njoftimin e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike.



# JTËSE NDAJ KORONAVIRUSIT



qytetarët e Kosovës do ta marrin përmes një SMS nga Posta numrin në të cilin do të mund të thërrasin që të marrin këshilla mjekësore dhe udhëzime si të veprojnë kur kanë shqetësime lidhur me koronavirusin. “Dmth., përveç numrave 112, 192 (Policia), 193 (Zjarrfikësit) dhe 194 (Shërbimet emergjente), tani qytetarët do t’i marrin këshillat e nevojshme edhe përmes numrave të tjerë të cilët Ministria do t’ua vë në dispozicion 24/7”, ka deklaruar ministri.

Ndërsa drejtori ekzekutiv i IKShPK-së, Naser Ramadani, ka thënë se deri sot në Kosovë janë testuar 82 mostra të dyshimta për Covid 19 dhe që të gjitha kanë rezultuar negative. Ai ka treguar se gjatë ditës së enjte po testohen edhe 10 mostra të tjera, rezultatet e të cilave pritet të dalin në orët e mbrëmjes. “Ne kemi filluar të testojmë që nga shkurti. Deri më tani janë testuar 82 pacientë. Janë edhe disa të tjerë për të cilët priten analizat. Nuk ka rritje të intensitetit të pacientëve që duhet të testohen. Disa pacientë kanë dalë grip A ose grip B ose edhe ftohje të lehta”, ka thënë Ramadani.

## Formohet komisioni i posaçëm për parandalimin e infeksionit me koronavirus

Qeveria e Kosovës në mbledhjen e së enjtes ka formuar komisionin e posaçëm për parandalimin e infeksionit me koronavirusin Covid 19.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se ky komision ka për obligim që t’i shpërndajë materialet e domosdoshme nëpër qendrat mjekësore në të gjitha komunat, te policia, doganierët dhe te të gjitha shërbimet e tjera emergjente. “Të përgatiten objekte të nevojshme për vendosjen e personave të prekur. Hyrje-daljet e qytetarëve nga Kosova të kontrollohen nga personeli shëndetësor. Bizneset ta kryejnë punën e tyre me nder e përgjegjësi, të mos i lëvizin çmimet, dhe institucionet përkatëse të kontrollit të dalin në terren ku ofrohen materialet bazike”, ka thënë Kurti.

## Rekomandimet nga Qarkorja Informative:

1. Të kufizohet rreptë lëvizja e shoqëruesve dhe familjarëve të pacientëve, si dhe prezenca e personave të pauniformuar në ambientet e urgjencës/emergjencës dhe në institucionet spitalore.
2. Në të gjitha institucionet shëndetësore të vendit (publike dhe private), të kenë të përgatitura dhoma të veçanta për rastet e dyshimta (posaçërisht në Klinikën Infektive të QKUK-së, si dhe në institucionet tjera spitalore të vendit).
3. Të realizohet kontrolli maksimal dhe inspektimet në të gjitha institucionet shëndetësore të vendit (publike dhe private).
4. Në të gjitha institucionet shëndetësore të vendit (publike dhe private), të shtohet kontrolli i brendshëm profesional në baza ditore duke implementuar rekomandimet e instancave të larta të Kosovës.
5. Të rritet në maksimum përkujdesja e stafit mjekësor dhe jo mjekësor ndaj higjienës personale dhe institucionale.
6. Të aplikohen nga personeli shëndetësor masat mbrojtëse konform udhëzimeve të OBSH të e ECDC-së, të përditësuara nga IKSHPK.
7. Të vendosen materialet informuese dhe edukative për parandalimin e COVID-19 në institucionet shëndetësore, dhe në institucionet tjera publike dhe private - nga përgjegjësit e tyre.
8. Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (përfshirë gjithë qendrat e mjekësisë familjare ne vartësi të saj), Spitalet Rajonale, si dhe ambulancat dhe spitalet private t’i raportojnë informatat rreth rasteve të rënda klinike mbi baza ditore direkte (sipas udhëzimeve) dhe me mjetet më të shpejta të Institutet Rajonale të Shëndetësisë Publike.
9. Institutet Rajonale të Shëndetësisë Publike do t’i përpunojnë të dhënat dhe varësisht nga ecuria epidemiologjike raportojnë menjëherë Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike me mjetin më të shpejtë të komunikimit dhe dorëzojnë raportet javore të kompletuara në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike.
10. Marrja e mostrave për konfirmim laboratorik do të bëhet vetëm te pacientët me simptome klinike të bazuara në definim të rastit në Klinikën Infektive të QKUK.
11. Personeli i Klinikës Infektive të QKUK i dërgon mostrat për testim laboratorik dhe raporton për të gjitha rastet e hospitalizuara duke e plotësuar pyetësorin përkatës.
12. Rekomandohet shmangie e udhëtimeve në vende të cilat janë me rrezik të lartë dhe të mesëm, në përputhje me listën e Organizatës Botërore Shëndetësore.
13. Të përforcohet pjesëmarrja e vullnetarëve të Kryqit të Kuq dhe vullnetarëve tjerë, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, në të gjitha vendkalimet kufitare.

## KMDLNj kërkon masa shtesë për mbrojtje nga koronavirusi për personat e privuar nga liria në qendrat e ndalimit

**Prishtinë, 12 mars** - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka kërkuar nga institucionet e vendit të tregohen të vëmendshme dhe të reagojnë në përputhje me rrezikun për shëndetin e një grupi të margjinalizuar të shoqërisë së Kosovës për personat e privuar nga liria.

KMDLNj ka kërkuar masa shtesë për mbrojtje nga koronavirusi për personat e privuar nga liria në qendrat e ndalimit, të paraburgimit dhe korrektuese. “KMDLNj është i informuar se Shërbimi Shëndetësor i Burgjeve, që është nën përgjegjësi të Ministrisë së Shëndetësisë, e ka bërë një plan veprimi dhe ka ndërmarrë masa për ballafaqim me rastet eventuale të të prekurve nga koronavirusi. Në të njëjtën kohë, ministrja e Drejtësisë, znj. Albulena Haxhiu, në një takim me drejtorët e qendrave të Paraburgimit dhe atyre Korrektuese, i ka njoftuar për masat e Qeverisë së Kosovës kundër koronavirusit në përgjithësi dhe mbrojtja e personave të privuar nga liria, në veçanti. KMDLNj i përkrah këto veprime dhe përpjekje por, duke i ditur rrethanat dhe kushtet në qendrat e Ndalimit Policor, Qendrat e Paraburgimit dhe Qendrat Korrektuese, për ta mbrojtur shëndetin e personave të privuar nga liria dhe stafit korrektues si dhe oficerëve, nevojiten masa shtesë në përputhje me rrezikun potencial”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

KMDLNj ka bërë me dije se Qeveria e Kosovës duhet të ndajë mjete




shtesë për Shërbimin Korrektues të Kosovës në mënyrë që t’i përmirësojë kushtet higjienike në Qendrat e Paraburgimit dhe ato Korrektuese si dhe ta begatojë menynë ushqimore me artikuj të domosdoshëm për këtë situatë.

# Borrelli, Kurtit: Na duhet heqja e plotë e taksës



PRISHTINË, 12 MARS - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bërë me dije se ka pranuar një letër nga përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell. Siç njofton Zyra për Komunikim e Kurtit, Borrelli në letrën e tij është shprehur i kënaqur me kryeministrin që, siç ka thënë, "marrëdhënien me BE-në e ka vënë si punë të tijën kryesore". "Ngjashëm, unë e mirëpres synimin tuaj për vazhdimin e reformave të domosdoshme që ta shtyni përpara sundimin e ligjit, zhvillimin ekonomik dhe qeverisjen e mirë në Kosovë. Këto janë elemente kyçe për të ardhmen tuaj", ka thënë Borrell.
Ai ka përmendur edhe dialogun me Serbinë, ndërsa ka thënë se Bashkimi Evropian dhe shtetet e tij anëtare "besojnë fuqishëm se rifillimi i bisedimeve është i domosdoshëm dhe urgjent" dhe se "do ta kërkojë heqjen e plotë të tarifave". "Unë e mirëprita njoftimin tuaj javën e kaluar për tarifat, që paraqet hap të parë të mirë në drejtim të duhur. Neve na duhet heqja e plotë e tarifave. Në këtë kontekst unë pajtohem plotësisht me ju se marrëveshjet e kaluara dhe obligimet e mbetura duhet të zbatohen plotësisht. Serbia, sikur Kosova, duhet t'i përmbushë zotimet për zbatimin e atyre marrëveshjeve", ka thënë mes tjerash Borrell.
Kosova u ka vënë taksë 100 për qind prodhimeve të importuara nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina qysh në nëntor të vitit 2018.
Ditë më parë Kurti ka shpalosur planin e tij për heqjen graduale të kësaj takse.
Shtetet e Bashkuara kanë kërkuar heqjen e plotë të saj.
Ka pasur edhe paralajmërime për tërheqjen e ushtarëve amerikanë nga Kosova, për shkak të mungesës së një vendimi nga Qeveria e Kosovës për heqjen e plotë të taksës. Taksa ka bërë që edhe dialogu për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi të ndërpritet qysh në fund të vitit 2018. Serbia e ka kushtëzuar rikthimin në dialog me heqjen e taksës. Kosova kërkon që Serbia ta ndalë fushatën për çnjohjet e pavarësisë së saj.

# Komunitetet në Kosovë për ruajtjen e trashëgimisë kulturore

PRISHTINË, 12 MARS (ER) - Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, mori pjesë të enjten në ceremoninë përmbyllëse të projektit të UNDP-së në Kosovë "Dialogu ndërmjet komuniteteve përmes ruajtjes gjithëpërfshirëse të trashëgimisë kulturore". Ministrja theksoi bashkëpunimin e shkëlqyer dhe implementimin e suksesshëm të projektit, i cili përmes ruajtjes gjithëpërfshirëse të trashëgimisë kulturore ka pasur të integruar tre komponentë që përfshijnë, përpos trashëgimisë së paluajtshme, edhe trashëgiminë shpirtërore, si dhe komponentin e promovimit dhe edukimit.
Ministrja Dumsohi në ceremoninë e organizuar deklaroi se MKRS-ja vlerëson lart bashkëpunimin me UNDP-në, në veçanti procesin e konsultimeve në përzgjedhjen e aseteve të trashëgimisë kulturore, ku përzgjedhja ka përfshirë brenda vetes kategori të ndryshme të trashëgimisë së paluajtshme, si: ura, kinema, muze, shkolla, kisha, e varreza.
Dumoshi theksoi edhe rëndësinë e projekteve që janë zbatuar e i kanë kontribuar diversitetit dhe përfshirjes të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Republikën e Kosovës. Në fund ministrja Dumoshi u zotua se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është e gatshme që në të ardhmen ta ofrojë bashkëpunimin në funksion të mbrojtjes, ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore.



# Dorëzohen në polici dëshmi për vrasjen e 112 fëmijëve gjatë luftës në Gjakovë



PRISHTINË, 12 MARS - Shoqata për krime lufte "Gjakova '98-'99" ka dorëzuar në polici kontingjentin e 14-të të dëshmive kundër krimeve serbe të luftës në Kosovë. Shkëndije Hoda nga kjo shoqatë ka bërë me dije se kanë dorëzuar dëshmi për vrasjen e 97 qytetarëve të Gjakovës nga forcat serbe. "Kësaj here kemi ardhur me disa dosje të tjera. Sa iu përket procedurave ligjore, ne s'jemi kompetentë të flasim për to. Djemtë dhe vajzat e policisë së Kosovës janë të mobilizuar në këtë çështje. Jemi të kënaqur me punën e tyre. Besoj se shumë shpejt do të kemi reagimet. Kemi sjell datat 7, 8, 9, 10 maj që është kryer një luftim shumë i ashpër në Komunën e Gjakovës, janë të vrarë dhe ekzekutuar dhe masakruar diku 97 qytetarë, kemi të burgosur 347 persona të cilët një pjesë janë lëshuar dhe të tjerët janë mbajtur në burgjet e Serbisë. Gjithashtu, kemi dosjet e 23 të vrarëve në burgun e Dubravës për këtë periudhë", ka thënë ajo. Një pjesë tjerë e dosjeve, sipas saj, ka të bëjë me 112 fëmijë të vrarë dhe ekzekutuar në mënyra të ndryshme në Gjakovë. "Pjesa tjetër është dosja e 112 fëmijëve të vrarë dhe ekzekutuar në mënyra të ndryshme në Komunën e Gjakovës", ka thënë Hoda.

## Kurti takohet me Apostolovan, flasin për taksën dhe për vizitën në Bruksel

Prishtinë, 12 mars (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur të enjten në takim përfaqësuesen speciale të BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova. Një nga temat e takimit ishte vizita zyrtare e kryeministrit Kurti në Bruksel. Nga ana e saj, Apostolova përsëriti rezultatin pozitiv të heqjes graduale të tarifës me Serbinë. Në lidhje me heqjen e plotë të tarifës, kryeministri Kurti argumentoi se heqja e plotë e saj do të vijë si rrjedhojë e vendosjes së besimit në respektin e plotë e të ndërsjellët mes të dyja palëve.



# Zgjedhjet në Podujevë nuk shtyhen

Zgjedhjet e jashtëzakonshme në Komunën e Podujevës do të mbahen të dielën, më 15 mars, ashtu siç ishte planifikuar më herët, kanë bërë me dije zyrtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Valmir Elezi, zëdhënës në këtë komision, ka thënë se pas masave që ka ndërmarrë Qeveria e Kosovës për parandalimin e koronavirusit, KQZ-ja ka komunikuar me institucionet përgjegjëse lidhur me masat që duhet t'i ndërmarrë ajo si institucion që i organizon zgjedhjet



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 12 MARS - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka bërë me dije se zgjedhjet për kryetar të Podujevës do të mbahen ashtu siç është vendosur, më 15 mars, pavarësisht prej masave mbrojtëse të marra nga Qeveria e Kosovës për t'u përballur me koronavirusin.
KQZ-ja ka treguar se nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës ka rekomanduar të ndërmerren masa gjatë ditës së votimit në qendrat e votimit dhe në vendvotime.
Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka thënë se pas vendimit të Qeverisë së Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka komunikuar të enjten me institucionet përgjegjëse lidhur me masat që duhet të ndërmerren nga KQZ-ja si institucion që organizon zgjedhjet. "Ne kemi kërkuar një përgjigje nga Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës që të na këshillojnë nëse KQZ-ja duhet të ndërmarrë ndonjë masë urgjente mbrojtëse specifike shëndetësore në ditën e zgjedhjeve më 15 mars 2020. Gjatë ditës ne kemi pranuar disa rekomandime nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, të cilat duhet të ndërmerren gjatë ditës së votimit në qendrat e votimit dhe në vendvotime. Pra, këto rekomandime/udhëzime, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do t'i përcjellë te menaxherët e qendrave të votimit, anëtarët e këshillave të vendvotimit dhe te stafi tjetër që do të angazhohet në këto zgjedhje", ka thënë ai.
Elezi ka theksuar se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve inkurajon subjektet politike që të sillen konform masave, kufizimeve, të ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Kosovës sa i përket çështjes së tubimeve publike. "Masat e kërkuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës kanë të bëjmë me higjienën dhe reduktimin e kontakteve", ka thënë ai.
Zgjedhjet e jashtëzakonshme në Podujevë pasojnë dorëheqjen e Agim Veliut nga pozita e kryetarit të komunës, pas emërimit të tij ministër i Punëve të Brendshme.

## Demokracia në Veprim anulon misionin e vëzhgimit për zgjedhjet në Podujevë

Rrjeti i organizatave për vëzhgimin e zgjedhjeve Demokracia në Veprim ka njoftuar se për shkak të situatës me virusin COVID-19 dhe me qëllim të garantimit të shëndetit të vëzhguesve, ka marrë vendim ta anulojë misionin e vëzhgimit të zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar të Podujevës. "Duke qenë se procesi i votimit në thelb është aktivitet publik dhe në të përfshihet një numër i konsiderueshëm i qytetarëve, DnV vlerëson se është e domosdoshme që të merren masat e nevojshme për parandalimin e shpërndarjes së këtij virusi. Prandaj, DnV kërkon nga presidenti i vendit, që bazuar edhe në rekomandimet e institucioneve shëndetësore, në bashkëpunim me qeverinë, partitë politike garuese dhe KQZ-në, ta rishqyrtojë vendimin për mbajtjen e zgjedhjeve për kryetar të Komunës së Podujevës", është bërë me dije në njoftimin për media të Demokracisë në Veprim.

# Reka kërkon nga nënkryetari i PE-së përkrahje për liberalizimin e vizave

PRISHTINË, 12 MARS (ER) - Ministri i Integrimit Evropian, Blerim Reka, ka pritur të enjten nënkryetarin e Parlamentit Evropian, Rainer Wieland, i shoqëruar nga delegacioni i tij gjerman. Ministri Reka ka falënderuar nënkryetarin e Parlamentit Evropian, Rainer Wieland, për mbështetjen e gjertanishme të Kosovës në procesin e saj integrues. Njëkohësisht, e njoftoi Wielandin për proceset aktuale dhe ecurinë me agjendën evropiane të Kosovës, ku theksoi rëndësinë e bashkëpunimit dhe koordinimit të punëve me përfaqësuesit e Parlamentit Evropian.
Me këtë rast ministri Reka nëpërmjet Wielandit ka kërkuar nga Parlamenti Evropian që ta vazhdojë përkrahjen për Kosovën posaçërisht në tri prioritet kyçe që ka: liberalizimi i vizave, implementimi i MSA-së dhe përgatitja për programimin me fondet e IPA III.
Ministri Reka beson se Parlamenti Evropian dhe deputetët e saj do të vazhdojnë të jenë zë i fuqishëm në mbështetje të perspektivës evropiane të Kosovës. Nga ana e tij, nënkryetari i Parlamentit Evropian, Rainer Wieland, ka uruar ministrin Reka për detyrën e re, si dhe ka shprehur entuziazmin për formimin e qeverisë së re, për dinamizimin dhe funksionalizimin e institucioneve në funksion të qeverisjes së mirë dhe sundimit të rendit e ligjit në vend.



## KRU "Prishtina" nis zbatimin e masave kundër koronavirusit

PRISHTINË, 12 MARS (ER) - Pas vendimit të Qeverisë së Kosovës për masat kundër përhapjes së koronavirusit, ka nisur menjëherë zbatimi i tyre nga Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina". Lidhur me këtë, ushtruesi i detyrës së kryeshefit ekzekutiv, Kapllan Parduzi, bashkë me stafin e tij ka nisur menjëherë zbatimin e masave kundër përhapjes së koronavirusit si dezinfektimi në të gjitha objektet e KRU "Prishtina" dhe mjeteve transportuese të punës. "Ne kemi obliguar në të njëjtën kohë edhe laboratorin e akredituar të kompanisë që të merret me sigurimin e klorit për ujin e pijshëm dhe kimikateve të tjera në funksionim të mirëfilltë të trajtimit të ujit në tri fabrikat trajtuese dhe, po ashtu, ta monitorojnë vazhdimisht cilësinë e ujit të pijshëm. Po ashtu, maska të mjaftueshme për punëtorë, pajisje higjienike për objektet prodhuese dhe administrative", është theksuar në njoftimin e KRU "Prishtina". KRU "Prishtina" ka obliguar shërbimin e burimeve njerëzore që në bazë të vendimit të Qeverisë së Kosovës ta lirojë njërin prind nga puna, deri më datë 27 mars, në mënyrë të përkujdesjes për fëmijët deri në moshën 10-vjeçare, pas ndërprerjes së mësimit në të gjitha nivelet.




INSTITUCIONET E KOSOVËS JANË MOBILIZUAR NDAJ MANIPULIMIT TË RRITJES SË ÇMIMEVE NGA ANA E MARKETEVE

# KORONAVIRUSI SHTYN QYTETARËT TË FURNIZOHEN ME PRODUKTE USHQIMORE, MARKETET RRISIN ÇMIMET

Në Kosovë ende nuk është shënuar asnjë rast i konfirmuar me koronavirus por, përkundër kësaj, qytetarët të mërkurën dhe të enjten kanë vërshuar marketet për t'u furnizuar me ushqime e gjësende të tjera, në rast se do t'u duhet të izolohen nëpër shtëpitë e tyre. Duke e parë këtë reagim të qytetarëve, shumica e marketeve të mëdha kanë ngritur çmimet. Ndaj ngritjes së çmimeve ka pasur reagim nga institucionet e vendit dhe shoqëria civile



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 12 MARS - Blerja dhe krijimi i rezervave të produkteve ushqimore, barnave dhe atyre sanitare e higjienike, tashmë është një dukuri që po manifeston frikën dhe panikun e krijuar te shumë qytetarë nga përhapja e koronavirusit. Në Kosovë ende nuk është shënuar asnjë rast i konfirmuar me koronavirus por, përkundër kësaj, qytetarët vazhdojnë të furnizohen me ushqime e gjësende të tjera, në rast se do t'u duhet të izolohen nëpër shtëpitë e tyre.

Duke e parë këtë panik të qytetarëve për t'u furnizuar me ushqime e gjësende të tjera, shumica e marketeve të mëdha kanë ngritur çmimet. Ndaj ngritjes së çmimeve ka pasur reagim nga institucionet e vendit dhe shoqëria civile.

Zëvendëskryeministrit Haki Abazi u ka bërë thirrje qytetarëve që të mos shpenzojnë për krijimin e rezervave ushqimore, pasi që aktualisht në Kosovë ka sasi të mjaftueshme të ushqimeve dhe se të gjithë dyqanet janë duke punuar me kapacitete të plota.

Ndërkohë të enjten ministri i Financave dhe Transfereve, Besnik Bislimi, ka vizituar Administratën Tatimore të Kosovës (ATK), nga e cila ka kërkuar masa rigoroze ndaj bizneseve që janë duke e keqpërdorur situatën e fundit për ngritje të çmimeve.

Bislimi ka thënë se situata e fundit nga rreziku i koronavirusit nuk duhet të keqpërdoret ose shfrytëzohet për pasurim të bizneseve, duke dëmtuar qytetarët dhe buxhetin e shtetit.

Ministri Bislimi ka ftuar ATK-në që të jetë në terren dhe të marrë masa ndaj atyre që bëjnë vepër penale për ngritjen e çmimeve. Edhe drejtori i ATK-së, Ilir

## BERZh-i ofron përkrahje në projektet energjetike

PRISHTINË, 12 MARS (ER) - Ministri i Integrimit Evropian, Blerim Reka, ka pritur të enjten në takim shefin e zyrës në Kosovë të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), Neil Taylor, me të cilin ka diskutuar për ndihmën dhe mbështetjen e kësaj banke në projektet energjetike, infrastrukturore dhe ekologjike.

Siç u përmend nga shefi i zyrës së BERZh-it në Kosovë, BERZh-i vazhdon edhe më tutje në implementimin e projekteve të cilat nga viti 2012 e deri në muajt e ardhshëm të këtij viti do ta arrijnë shumën e përgjithshme të afër gjysmë miliard euro të investimeve nga kjo bankë.

I njëjti ka theksuar se fushat prioritare që BERZh-i vazhdon të mbështesë dhe të ketë në fokus të mbështetjes financiare do të jenë ato në energjinë alternative të erës, në sektorin energjetik si tërësi, në sektorin e infrastrukturës, si dhe në sektorin privat. Me këtë rast, u theksua se BERZh-i është e interesuar që të balancohen investimet në mes të sektorit të energjisë dhe asaj të ekologjisë, për një ambient më të pastër në Kosovë, në funksion të kontributit praktik të Kosovës për plotësimin e objektivave të Agjendës së Gjelbër Evropiane në vend. Palët u pajtuan që ta vazhdojnë bashkëpunimin për konkretizimin e aktiviteteve në funksion të zbatimit të këtyre projekteve.



# Nga sot pezullohen fluturimet nga Gjermania, Franca, Zvicra e Italia drejt Kosovës

**Prishtinë, 12 mars (ER)** - Ministri i Infrastrukturës, Lumir Abdixhiku, ka bërë me dije se të enjten është marrë vendim që të pezullohen përkohësisht të gjitha fluturimet për zonat me rrezik të mesëm dhe të lartë nga koronavirusi.
Abdixhiku përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka thënë se janë pezulluar linjat ajrore dhe tokësore për në Gjermani, Francë, Zvicër dhe Itali.
"Në vazhdimësi të vendimit të djeshëm të qeverisë, sot kam pranuar nga ministri i Shëndetësisë rekomandimin e IShK-së për zonat me rrezik të mesëm e rrezik të lartë. Si rrjedhojë kam marrë vendim t'i pezulloj përkohësisht të gjitha ardhjet e linjave ajrore dhe tokësore nga këto shtete: Gjermani, Francë, Zvicër dhe Itali. Për qëllim të organizimit, vendimi hyn në fuqi 24 orë nga tani. Pra, nesër, më 13 mars, në orën 15:00. Ndiejmë keqardhje sërish për këto masa, por në rrethanat e tanishme jemi të paalternativë. Lus qytetarët t'i reduktojnë lëvizjet me jashtë sepse masa të njëjta mund të merren edhe me shtetet e tjera. Si vend e si shtet, me qetësi e pa panik, do ta kalojmë edhe këtë sfidë", ka shkruar ai.




Murtezaj, ka thënë se do t'i respektojnë të gjitha kërkesat e qeverisë për mbrojtjen e konsumatorëve. "Të mos keqpërdoren situatat me qëllim të përfitimit. Do të bashkëpunojmë ngushtë me prokurorinë e shtetit. Nga nata e mbrëmshme ka raste që janë ngritur çmimet. Ne do të bëjmë inspektim në terren. Do të jemi të pakompromis ndaj atyre që keqpërdorin këtë situatë", ka thënë Murtezaj.
ATK-ja ka vënë në dispozicion një numër kontaktues ku qytetarët mund t'i lajmërojnë rastet ku vërejnë ngritje të çmimeve në barnatore ose markete. 0800 80 800 është linja pa pagesë, ku qytetarët e Kosovës mund të raportojnë nëse ka rritje çmimesh në norma të larta, si dhe në linjën 038 222 165 me pagesë.
Po ashtu, lidhur me situatën e krijuar së fundmi ka reaguar edhe Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, duke nisur kështu hetimet për të gjitha bizneset dhe kompanitë farmaceutike për ngritjet e çmimeve. Kryetari i këtij institucioni, Valon Prestreshi, ka deklaruar se në bazë të hetimeve do të shohin nëse ka marrëveshje mes bizneseve dhe furnizuesve për ngritjen e çmimeve. "Autoriteti si institucion i pavarur në kryerjen e detyrave të veta angazhohet që të parandalojë çfarëdo lloj shkelje të mundshme të konkurrencës në gjithë territorin e Kosovës. Nga ajo që kemi parë në media dhe analiza në terren, kemi parë një fluks të madh të njerëzve që u janë drejtuar dyqaneve të mëdha të shitjes së produkteve ushqimore. Për këtë arsye autoriteti dëshiron të sigurohet se operatorët tregtarë nuk e keqpërdorin situatën e krijuar për të përfituar nga qytetarët", ka deklaruar Prestreshi. Sipas tij, pas vlerësimit të gjitha fakteve do të ndërmarrin vendimet për gjoba. "Ju njoftoj se inspektorët hetues të Autoritetit të Konkurrencës do të jenë të mobilizuar nga dita e sotme për të kryer hetime në lidhje me këtë rast të ngritur nga qytetarët dhe mediat. Gjatë kësaj faze autoriteti do t'i grumbullojë të dhënat nga operatorët e tregut dhe institucionet kompetente siç është Dogana, ATK-ja dhe të tjerat para se të merret një vendim për fillimin e procedurës hetimore. Autoriteti do t'i vlerësojë faktet për shkelje të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës duke kryer sjellje antikonkurruese që do ta bënte autoritetin t'i marrë vendimet e përshtatura me situatën", ka thënë Prestreshi.
Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, përmes një konference për media ka thënë se nuk duhet të ketë panik të qytetarët pasi, sipas tij, bizneset kanë konfirmuar se ka rezerva të mjaftueshme. "Epidemia është shfaqur në tërë botën dhe ka çrregulluar tregjet si panik dhe po ndodhë si recension ekonomik. Më shumë ka panik sesa është realitet. Fuqitë e mëdha po testojnë forma të ndryshme në aspekt politik e ekonomik. Kosova është një ndër vendet më të siguruara. Është duke u krijuar panik i panevojshëm. Siç po shihet, bizneset janë duke e keqpërdorur këtë situatë", ka thënë Shahini, duke u bërë thirrje bizneseve që t'i furnizojnë qytetarët ashtu siç kanë bërë edhe në të kaluarën. "U bëj ftesë gjitha bizneseve të mos bëjnë panik dhe t'i furnizojnë qytetarët ashtu siç e kanë bërë edhe më herët. Bizneset kanë deklaruar se kanë rezerva të mjaftueshme", ka thënë Shahini.
Edhe kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, në një konferencë për media ka treguar për masat që kanë marrë kundër koronavirusit. Ai ka thënë se do të krijohet një task-forcë brenda OEK-ut për t'i përcjellë bizneset që ngritin çmimet. "Do ta krijojmë edhe një task-forcë. Kemi kërkuar që aty ku kemi informacion për ngritje të çmimeve të raportohet. Unë mendoj se bizneset serioze nuk e bëjnë një gjë, por nëse ka do të ketë ndjekje penale", ka thënë Rukiqi, duke shtuar se nuk kanë vërejtur problem me furnizim me produkte ushqimore.
Kurse ministrja e Ekonomisë, Rozeta Hajdari, ka bërë me dije se përmes një urdhërese të enjten kanë vendosur ta kufizojnë ngritjen e çmimeve pas gjendjes me pandeminë koronavirus në pothuajse të gjithë botën. Në mbledhjen e jashtëzakonshme të Qeverisë së Kosovës, ajo tha se këtë urdhëresë e ka marrë në bazë të ligjeve, teksa iu bëri thirrje inspektorëve të tregut për të dalë në terren dhe t'i marrë masat përkatëse.
Ministri i Financave, Besnik Bislimi, ka deklaruar se dikasteri që ai udhëheq po ashtu ka marrë vendim për ta parandaluar manipulimin me çmime të artikujve ushqimorë. Ai ka thënë se nuk ka kufizime të mallrave nga ana e Kosovës dhe Shqipërisë.






# Ministri Mustafa pret në takim ambasadorin Kosnett, e informon për sektorin e bujqësisë

**Prishtinë, 12 mars (ER)** - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, ka takuar të enjten ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, Philip Kosnett, i cili i ishte i shoqëruar nga drejtori i Zyrës për Zhvillim Ekonomik në USAID, Joshua Mike dhe specialistja e menaxhimit të projekteve në USAID, Besa Ilazi.
Ministri Mustafa ka falënderuar ambasadorin Kosnett për mbështetjen që shteti i tij, një mik i përhershëm, i ka dhënë Kosovës për avancimin e paqes, sigurisë dhe prosperitetit.
Mustafa ka shpalosur vizionin dhe programet zhvillimore që do të zbatohen në përkrahje të tre sektorëve të bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural gjatë këtij mandati. "Do të përqendrohemi për përkrahjen e rritjes së produktivitetit dhe cilësisë, duke subvencionuar outputet e jo inputet dhe duke rritur qasjen në financa për agroprodhuesit dhe agropërpunuesit përmes garantimit të agro-kredive investuese dhe themelimit të Fondit për Siguri Bujqësore", u shpreh ministri Mustafa.
Ndërkaq ambasadori Kosnett e uroi ministrin Mustafa për detyrën e re duke shprehur gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit mes dy shteteve tona.



## Ndahen 400 pako ushqimore për familjet në asistencë sociale në Skenderaj

SKENDERAJ, 12 MARS (ER) - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Skenderajt, me ndihmën e Shoqatës Humanitare "Duart e Bamirësisë", ka shpërndarë pako ushqimore për 400 familje të cilat janë në asistencë sociale. Pakot janë dhuruar përmes Qendrës për Punë Sociale e cila i ka ndarë këto ndihma te familjet përkatëse e në rastet e mungesës së tyre u janë dhuruar familjeve në pritje. Me këtë rast, drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Skenderaj, Ibush Hetemi, është shprehur mirënjohës ndaj shoqatës "Duart e Bamirësisë", duke e çmuar shumë ndihmën e tyre ndaj familjeve në nevojë në Komunën e Skenderajt.



# Komuna e Mitrovicës merr masa parandaluese rreth koronavirusit



MITROVICË, 12 MARS (ER) - Të enjten është mbajtur mbledhje e Bordit të Drejtorëve të Komunës së Mitrovicës, e cila është drejtuar nga nënkryetari i komunës, Faruk Mujka. Në këtë mbledhje janë diskutuar rekomandimet e ndërmarra nga Qeveria e Kosovës lidhur me masat parandaluese rreth koronavirusit.

Në këtë mbledhje ekzekutivi i komunës u pajtua që Komuna e Mitrovicës t'i njoftojë të gjithë qytetarët lidhur me këto rekomandime si masa parandaluese rreth virusit COVID-19. "1. Gjatë fundjavës do të dezinfektohen hollësisht të gjitha hapësirat e ndërtesave të Komunës së Mitrovicës, duke përfshirë këtu edhe institucionet shëndetësore dhe ato arsimore. 2. Punëtorët e sporteleve të Komunës së Mitrovicës do të pajisen me maska mbrojtëse, doreza dhe dezinfektues. 3. Ndalimi i veprimtarisë së klubeve restoranteve, klubeve të natës, palestrave, pishinave pas orës 23:00. 4. Të gjitha ndërmarrjet publike dhe kompanitë private që kryejnë transport publik të udhëtarëve duhet të bëjnë dezinfektim të rregullt të mjeteve transportuese. 5. Inspektim i vazhdueshëm i subjekteve afariste, në rast të ngritjes së çmimeve, do të gjobiten. 6. Lirimin nga vendi i punës të njërit prind për përkujdesje të fëmijëve", është thënë njoftimin e Komunës së Mitrovicës.

# Haziri, gjilanasve: Jetoni pa panik, por me kujdes e disiplinë në higjienë

GJILAN, 12 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka vizituar Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) dhe Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik (IKShP), nga ku është informuar se nuk ka vend për panik sepse deri më tani asnjë shenjë e koronavirusit nuk është paraqitur te pacientët e këtij regjioni dhe sipas monitorimeve permanente as në nivel të Kosovës. "Komuna e Gjilanit sot në mëngjes ka marrë vendimin e themelimit të ekipit ndërsektorial për menaxhimin e pandemisë sipas vendimit të qeverisë. Kam vizituar dy institucione, atë të QKMF-së dhe IKShP-së dhe jam njoftuar për masat e ndërmarra. Apeloj te të gjithë qytetarët e Gjilanit që të jenë të kujdesshëm, por pa shkaktuar panik. Gjithçka që është në varshmëri të këtyre institucioneve do të përballohet me lehtësi dhe nuk ka nevojë që të shqetësohemi. Jam duke punuar me institucionet e tjera për menaxhimin e hyrjeve përmes pikave kufitare që prekin Gjilanin. Të jetojmë në normalitet, por me kujdes dhe disiplinë në higjienë veçanërisht", ka thënë Haziri. Ai ka porositur të gjithë qytetarët që për çfarëdo shqetësimi në ndryshimet shëndetësore, t'u drejtohen institucioneve të shëndetësisë dhe t'i marrin udhëzimet dhe rekomandimet profesionale. Kurse në emër të



Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik ka folur Ajhane Sejfiu, e cila ka potencuar se nuk ka nevojë për panik, por duhet që fokusi të jetë në higjienën dhe disiplinën maksimale për ta tejkaluar këtë problem i cili ka përfshirë vende të shumta botërore.

## Falë Bullgarisë shkolla e fshatit Romajë të Hasit do të bëhet me terren sportiv



PRIZREN, 12 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka pritur të enjten në takim ambasadorin e Bullgarisë në Kosovë, Hristo Gudjev, me të cilin ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit mes kësaj komune dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Bullgarisë për ndërtimin e terrenit sportiv dhe oborrit të shkollës në fshatin Romajë të Hasit. Projekti i cili do të jetë me bashkëfinancim, ku pjesa më e madhe e investimit do të mbulohet nga Qeveria e Bullgarisë, është vetëm një prej investimeve të shtetit bullgar në Kosovë që po realizohen në fushën e arsimit, por edhe të shëndetësisë. Me këtë rast, kryetari Haskuka ka falënderuar përzemërsisht ambasadorin Gudjev dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme të Bullgarisë për këtë bashkëpunim, duke uruar që ky bashkëpunim në të ardhmen të jetë edhe më i gjerë. Ndërsa ambasadori Gudjev ka thënë se ndihet i nderuar që Qeveria e Bullgarisë ka marrë vendim për mbështetje financiare të një projekti siç është ky në shkollën e fshatit Romajë. Punimet deri në përfundim të projektit pritet të zgjasin rreth nëntë muaj.

# Kosova para vendimmarrjes që tejkalon kapriciet e brendshme

Kosova nuk duhet të presë twitin e radhës sepse ai mund të jetë i fundit, por duhet t'i mbledhë të gjitha fuqitë që t'i tejkalojë kapriciet e brendshme në favor të një zgjidhje që është e favorshme për të



Nga Mehmet PRISHTINA

Senatori amerikan David Perdue, siç raportojnë mediat, shkroi të martën se Shtetet e Bashkuara duhet ta rishqyrtojnë praninë në Kosovë nëse ajo nuk heq taksën 100 për qind ndaj Serbisë. Në një postim në rrjetin 'Twitter', senatori Perdue shkroi se "për më shumë se dy dekada forcat amerikane kanë ndihmuar në ruajtjen e paqes mes Kosovës dhe Serbisë. Tani, me përparimin e arritur historik, Kosova duhet të bëjë pjesën e vet dhe t'i shfuqizojë të gjitha tarifat e vendosura ndaj Serbisë. Nëse Kosova nuk është plotësisht e përkushtuar për paqen, atëherë Shtetet e Bashkuara duhet ta rishqyrtojnë praninë e atje", shkroi ai.

Ky është vetëm një sinjal që vjen përtej Atlantikut dhe as në ëndërr nuk do ta shihnim që do të vijë një ditë të flasim për (pa)mundësinë e largimit të pranisë ushtarake amerikane nga Kosova, në rrethana të tilla kaq banale e teknike, në shikim të parë, por shumë problematike në rrafsh gjeostrategjik.

Sinjale të tilla nga Uashingtoni kanë ardhur edhe prej zyrtarëve e emisarëve të tjerë amerikanë. Amerika nuk do të qëndrojë përgjithmonë në Kosovë, por shqiptarët nuk duhet të bëhen shkaktarë të keqkuptimeve për ndonjë rishqyrtim serioz të vendimeve amerikane.

Është evidente kriza nëpër të cilën po kalon aktualisht politika e Kosovës, qoftë ajo që udhëhiqet nga qeveria, qoftë nga opozita, por është e pafalshme të prishemi me miqtë tanë më të mëdhenj - amerikanët për shkak të mosmarrëveshjeve tona të brendshme. Dimensionet e kësaj krize bëhen edhe më shqetësuese për faktin se edhe brenda koalicionit qeverisës ka plasaritje dhe mospajtime sa iu përket masave dhe veprimeve që duhet të ndërmerren në raport me Serbinë siç është taksa 100 për qind. LDK ka dërguar një emisar të vetin në Uashington dhe ky është një hap i mjaftueshëm për të hyrë në një krizë qeverisëse si pasojë e mospajtimeve mbi domosdonë e heqjes së taksës, e kërkuar edhe nga ShBA, ku LDK dhe LV si partner të koalicionit, kanë qëndrime pak a shumë të ndryshme. Të gjithë vëzhguesit dhe analistët janë të një mendimi se taksa është vetëm një çështje teknike që nuk çon shumë peshë në finalizimin e raporteve me Serbinë në të ardhmen, sepse ajo çka pritet të debatohet në tryezën e negociatave është më substanciale dhe shumë fish më jetike se taksa 100 për qind.

Në anën tjetër, vetë Amerika ndodhet në një fazë mjaft interesante të zhvillimeve, si në planin e brendshëm, ashtu dhe në atë të jashtëm. Aktualisht jemi në kohën kur Amerika po kalon nga demokracia liberale në neoliberalizëm dhe kjo vetvetiu nënkupton një ndryshim tipologjik në vet strukturën e politikës amerikane.

Vendimet e mëdha politike të një shteti gjigant, siç është Amerika, udhëhiqen edhe nga zhvillimet globale, që prekin drejtpërdrejt interesat amerikane, ku gjithsesi bën pjesë edhe kriza energjetike si pasojë e luftërave gjeostrategjike për rrugët e transmetimit të gazit apo naftës.

Kosova sigurisht që është një pikë e vogël në këtë det të madh të zhvillimeve globale, ku SHBA-të kanë gjithsesi rolin dhe angazhimin e vet të rëndësishëm, por ajo që kërkohet nga klasa politike kosovare është të vlerësojë drejt momentumin në të cilin ndodhen marrëdhëniet ShBA-Kosovë dhe mundësisht të detektoj drejt pengesat që mund t'i vështirësojnë këto marrëdhënie.

Tani për tani është taksa 100 për qind ajo që ka krijuar ndasi si brenda skenës politik kosovare, ashtu edhe në raport me ShBA-të. Përveç kryeministrit Kurti, i cili ka një qëndrim ndryshe rreth kësaj problematike, të gjithë të tjerët (me përjashtim të AAK-së), përfshi edhe LDK-në, janë në valë të njëjta me Uashingtonin për heqjen pa kushte të taksës.

Kritikuesit e kryeministrit Kurti pretendojnë se ai këtë qëndrim po e mban i nxitur nga motivet e një politikani i cili në vendimmarrjen e tij dëshiron të ketë konsistencë dhe mos ikje nga premtimet e dhëna në fushatën zgjedhore.

Mbështetësit e kryeministrit Kurti, në anën tjetër, mendojnë se lideri i tyre nuk është kundër Amerikës, por ai ka qëndrim të prerë sa i përket raporteve me Serbinë, duke kërkuar nga kjo e fundit t'i përmbahet disa rregullave e parimeve që janë të domosdoshme në mes të dy partnerëve të barabartë në tavolinën e bisedimeve.

Edhe kritikuesit edhe mbështetësit e kryeministrit Kurti flasin në emër të interesave të Kosovës, por nëse në të ardhmen nuk do ta kemi mbështetjen e ShBA-ve, atëherë kot flasim për ato interesa. Agjendat politike të udhëheqësve të Kosovës mund të jenë shumë objektive dhe të dobishme për qytetarët e vendit, por jo gjithmonë shtetet me kapacitete të limituara ushtarake, ekonomike e zhvillimore, siç është Kosova, mund t'i realizojnë 100 për qind për qind ato agjenda.

Nëse Kosova shumë shpejt nuk e gjen një rrugë të vetme që do ta bënte më të akceptueshme për politikën e jashtme amerikane, atëherë mund të ndodhë që në zgjidhjen final të raporteve me Serbinë të ngelim me disa faktorë ndërkombëtarë, të cilët mund të mos e kenë ndjeshmërinë e momentit për të vendosur në favor të rrjedhës logjike të zhvillimeve që nga koha e bombardimeve të NATO-s e deri te shpallja e pavarësisë së Kosovës, duke lënë hapur problemin e pazgjidhur me Serbinë. Nëse dilet nga kjo rrjedhë, atëherë sërish do të kemi nevojë për një aleat të fuqishëm, por atëherë mund të jetë vonë.

Kosova nuk duhet ta presë twitin e radhës sepse ai mund të jetë i fundit, por duhet t'i mbledhë të gjitha fuqitë që t'i tejkalojë kapriciet e brendshme në favor të një zgjidhje që është e favorshme për të.

# Ndërmjetësim apo dirigjim?



Ismajl KURTESHI

Subjektet politike shqiptare, analistët dhe qytetarët që po angazhohen për plotësimin e kërkesës së z. Grenell për heqjen e menjëhershme dhe pakushte të tarifës, këtë po e bëjnë nga frika e pasojave eventuale, por jo se po u pëlqen një kërkesë që është e ngjashme me atë të Serbisë.

Është normale që kur dikush është në telashe, ka probleme ose mosmarrëveshje, miqtë të përpiqen të ndihmojnë në tejkalimin e vështirësive (mosmarrëveshjeve).

Në rastet kur dikush përballet me mosmarrëveshje me këdo qoftë, miqtë ndërmjetësojnë dhe kërkojnë nga palët që mosmarrëveshjen ta tejkalojnë përmes një marrëveshjeje të pranueshme për palët që ballafaqohen me mosmarrëveshje për çështje të caktuar.

Ndërmjetësimi si akt i vullnet të mirë, për të kontribuar në tejkalimin e mosmarrëveshjes, është i dobishëm dhe si i tillë edhe i mirëpritur.

Ndodh ndonjëherë që ndërmjetësuesit të rrëshqasin nga ndërmjetësuesi në dirigjues. Zgjidhjet përmes dirigjimit janë të imponuara dhe si të tilla edhe nëse arrihen, janë afatshkurta, ato vetëm sa i thellojnë mospajtimin në mes të palëve, realisht ato nuk janë fare zgjidhje.

Angazhimi i ShBA-ve në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mes të Kosovës dhe Serbisë është mirëpritur nga shqiptarët gjithandej.

Të gjithë shqiptarët janë mirënjohës për përkrahjen e ShBA-së në kauzat e drejta për liri, pavarësi dhe shtete ndërtim që nga presidenti Willson, deri në ditën e sotme.

Përkundër konsideratës së lart për miqtë tanë strategjik, nuk mund të mos shprehim mospajtimin me kërkesën, e llojit merr ose le, në lidhje me tarifën.

Subjektet politike shqiptare, analistët dhe qytetarët që po angazhohen për plotësimin e kërkese së, z. Grenell, për heqjen e menjëhershme dhe pakushte të tarifës, këtë po e bëjnë nga frika e pasojave eventuale, por jo se po ju pëlqen një kërkesë që është e ngjashme me atë të Serbisë.

Subjektet politike shqiptare, analistët dhe qytetarët që po angazhohen për plotësimin e kërkese së, z. Grenell, për heqjen pakushte të tarifës, këtë po e bëjnë nga frika e pasojave eventuale, por jo se po ju pëlqen një kërkesë që është e ngjashme me atë të Serbisë.

Tarifa do të hiqet, marrëveshja do të arrihet me ndërmjetësimin e ShBA-ve dhe BE-së, pa imponime dhe vetëm me trajtim plotësisht të barabartë të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

Për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje që zanafillën e ka në vitin 1878, e sidomos në vitin 1912 kur Serbia me dhunë ja bashkoj Kosovën Serbisë;

Bisedimet duhet të zhvillohen, në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, për çështje ndërshtetërore, e jo si në të kaluarën kur u bisedua në mes të Prishtinës dhe Beogradit për çështje të brendshme të Kosovës.

## Gjermania vendos nën mbikëqyrje një fraksion të AfD-së



BERLIN, 12 MARS - Shërbimi i inteligjencës në Gjermani e vendosi një pjesë të partisë së ekstremit të djathtë, Alternativa për Gjermaninë (AfD), nën mbikëqyrje të vazhdueshme, për shkak të, siç u tha, kërcënimit për rendin demokratik.
Vendimi ka në shënjestër krahun Flugel, një grup i AfD-së që ka fuqi të madhe në Gjermaninë Lindore.
Flugel udhëhiqet nga Bjorn Hocke, një ligjvënës kontrovers nga shteti Tyringen.
Shërbimi i inteligjencës BfV e përshkroi Flugel-in si organizatë ekstremiste dhe tha se ky fraksion ka rreth 7,000 anëtarë ose 20 për qind të anëtarëve të AfD-së.
Mbikëqyrja është një çështje shumë e ndjeshme në Gjermani, ku shumë njerëz kanë kujtimet e spiunazhit abuziv nga kohët e komunizmit dhe nazizmit.
Hocke prej kohësh është akuzuar për retorikë nxitëse kundër Islamit dhe migrantëve.
AfD dhe veçanërisht Flugel janë kritikuar ashpër edhe për të shtënat e 19 shkurtit në Hanau, ku një person i armatosur, i nxitur nga motivet raciste, ka vrarë nëntë veta në dy bare.
Ai më pas ka vrarë nënën e tij dhe veten.
Shefi i BfV-së, Thomas Haldenwang, u tha gazetarëve të enjten se ekstremistët e djathtë janë përgjegjës për mbi 200 njerëz të vrarë në Gjermani, qysh në vitin 1990.

# Koronavirusi rëndon situatën në Evropë

**Italia vazhdon të jetë vendi më i goditur në Evropë, ndërsa vendet fqinje i frikësohen një impakti të ngjashëm gjatë ditëve në vijim, ndërkohë që kancelarja gjermane paralajmëroi se mund të infektohet deri në 70% e popullsisë**



BRUKSEL, 12 MARS - Kriza e koronavirusit po thellohet në Evropë, vetëm një ditë pasi kancelarja gjermane paralajmëroi se mund të infektohet deri në 70% e popullsisë. Në Britani, ministrja e Shëndetësisë u diagnostikua me koronavirus ndërsa numri i të infektuarve i kaloi 450 persona, rritja më e madhe kjo brenda një dite. Italia vazhdon të jetë vendi më i goditur në Evropë, ndërsa vendet fqinje i frikësohen një impakti të ngjashëm gjatë ditëve në vijim, ka njoftuar voa.
Epidemia në Itali filloi më pak se tre javë më parë. Tashmë ka infektuar dhjetëra mijëra njerëz, ka shkaktuar disa qindra viktima dhe ka detyruar një vend të tërë të izolohet. Në Lombardi, në Italinë Veriore, spitalet janë të mbingarkuara. I gjithë vendi po mundohet t'i përllogarisë humbjet.
"Ky është terror psikologjik", thotë Giulia, pronare dyqani.
Impakti ekonomik ndaj Italisë pritet të jetë brutal, me sistemet e transportit dhe bizneset e mbyllura, turistë që nuk udhëtojnë më dhe konsumatorët që qëndrojnë në shtëpi.
Ekspertët e shëndetësisë thonë se vendet e tjera do të pasojnë pas disa javësh Italinë, me epideminë që pritet të arrijë kulmin së shpejti.
Liderët politikë po përpiqen të përballen me sfidën dhe të udhëheqin nëpërmjet shembullit të tyre. Udhëheqësit e BE-së e zhvilluan takimin e tyre të martën nëpërmjet videokonferencës.
Ndërkaq, ministrja britanike e Shëndetësisë është diagnostikuar me koronavirus. Ajo u takua javën e kaluar me qindra ligjvënës në parlament dhe mori pjesë në një pritje të kryeministrit Boris Johnson.
Deri më tani, Britania ka qenë më e kujdesshme në vendosjen e kufizimeve ndaj lëvizjes.
"Vendosja e shtetrrethimit nuk është domosdoshmërisht gjëja e duhur. Është absolutisht i rëndësishëm momenti kur merret vendimi. Nëse vendoset para kohe, njerëzit nuk do ta zbatojnë për një periudhë të zgjatur", thotë dr. Jenny Harries, nëndrejtore e Shërbimit Mjekësor Britanik.
Banka e Anglisë bëri një ndërhyrje emergjence duke ulur me 0.5% normën e interesit, vetëm disa orë përpara se të paraqitej buxheti vjetor i qeverisë, i dominuar këtë vit nga masat ndaj koronavirusit. Buxheti parashikon 39 miliardë dollarë për të ndihmuar njerëzit dhe bizneset.
"Sado të kushtojë, do të mbështesim Shërbimin Kombëtar të Shëndetit. Gjithashtu, nëse njerëzit gjatë kësaj krize sëmuren ose nuk janë në gjendje të punojnë, duhet t'i mbështesim financiarisht. Duhet të sigurohemi që sistemi ofron mjaftueshëm garanci për t'iu rikthyer jetës normale", tha Rishi Sinak, Sekretari i Thesarit të Britanisë.
Në Spanjë, Greqi dhe Republikën Çeke, universitetet dhe shkollat janë mbyllur për të paktën dy javë. Udhëheqësja e Gjermanisë bëri të mërkurën një paralajmërim të fortë.
"Duhet të kuptoni se nëse virusi është këtu dhe popullsia nuk ka imunitet ndaj tij, ndërsa nuk kemi ende një vaksinë apo terapi, një përqindje e lartë e ekspertëve thonë se 60 – 70% e popullsisë do të infektohet për sa kohë vazhdon kjo situatë", tha kancelarja gjermane Angela Merkel.
Një virus që filloi në një qoshe të Kinës është përhapur tashmë në mbarë botën dhe po transformon mënyrën e jetesës së qindra miliona njerëzve.

## Tronditen tregjet e aksioneve, rënie në bursën e Nju Jorkut




NJU JORK, 12 MARS - Tregjet e aksioneve vazhdojnë të jenë të tronditura nga përhapja e virusit COVID-19 dhe ndikimi i kësaj pandemie në ekonomi.
Bursa në Nju Jork u pezullua për 15 minuta për shkak se treguesi S&P 500 ra më shumë se 7 për qind në hapje.
Po shtohet frika se përhapja e koronavirusit në Shtetet e Bashkuara do të bllokojë rritjen ekonomike dhe do ta çojë vendin drejt recesionit, një periudhë e tkurrjes ekonomike.
Shtëpia e Bardhë po shqyrton një sërë masash afatshkurtra për të zbutur tendosjen financiare për bizneset dhe punonjësit e prekur.
Indeksi Nikkei i Japonisë u mbyll me humbje prej 4.4% ndërsa indeksi Hang Seng i Hong Kongut ra me 3.7% kurse indeksi Shanghai i Kinës pësoi një rënie të vlerës prej 1.5%. Kurse tregjet australiane ranë më shumë se 7% të enjten.
Tregjet evropiane u goditën rëndë në orët e para të ditës ndërsa tregjet e Britanisë, Francës dhe Gjermanisë shënuan një rënie prej 6%.
Rënia e kërkesave për të udhëtuar, si rezultat i virusit të ri, po ashtu ka ndikuar në rënien e çmimit të naftës në tregjet botërore.


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L


Shijo Pranverën me...
Jaffa Champion PLUS
A+C+E
Multifrutti
Taste of World Wide Brand!
2L
Jaffa Champion

# Luftërat e Ballkanit, origjina dhe pasojat

Ballkani (ose Gadishulli i Ballkanit) është një rajon gjeopolitik dhe kulturor i Evropës juglindore. Rajoni e ka marrë emrin nga malet e Ballkanit, të cilat shtrihen përmes qendrës së Bullgarisë në Serbinë lindore.



Ndër vite, Ballkani ka qenë i njohur si burim konfliktesh e luftërash të përgjakshme. Madje dy nga luftërat më të mëdha të njohura si Luftërat Ballkanike, i kanë paraprirë Luftës së Parë Botërore.

Literal Media iu sjellë një pjesë të hulumtimit të Richard C. Hall nga Universiteti Shtetëror Jugperëndimor i Xheorxhisë.

Luftërat Ballkanike ishin dy konflikte të mprehta që paralajmëruan fillimin e Luftës së Parë Botërore. Në Luftën e Parë Ballkanike një aleancë e brishtë e shteteve të Ballkanit eliminoi Perandorinë Osmane nga shumica e Evropës. Në Luftën e Dytë Ballkanike, aleatët e hershëm luftuan midis tyre për plaçkën osmane.

### Origjina

Luftërat Ballkanike të viteve 1912-1913 inicuan një periudhë konflikti që shkatërroi Evropën juglindore deri në vitin 1918 dhe qëndruan atje në një formë ose një tjetër në shekullin XXI. Këto luftëra ballkanike filluan në aspiratat e shteteve nacionaliste të Evropës juglindore; pasi kishin arritur më parë pavarësinë nga Perandoria Osmane gjatë shekullit XIX, këto shtete dëshiruan të përfshijnë anëtarët e kombësive të tyre të mbetura nën sundimin otoman dhe kështu të arrijnë pretendimet e tyre maksimale nacionaliste. Në këtë mënyrë, shtetet e Bullgarisë, Greqisë, Malit të Zi dhe Serbisë u përpoqën të imitojnë sukseset nacionaliste të shekullit XIX të Gjermanisë dhe Italisë.

### Lufta e Parë Ballkanike

Mali i Zi filloi Luftën e Parë Ballkanike më 8 tetor 1912. Para se të mund të bashkoheshin aleatët e tjerë, osmanët i shpallën luftë Lidhjes Ballkanike më 17 tetor. Teatri kryesor i konfliktit që pasoi ishte Thrakia. Ndërsa një ushtri bullgare rrethoi fortesën kryesore otomane në Adrianopojë (Edirne), dy të tjerat arritën fitore të mëdha në Kirk Kilisse (Lozengrad) dhe në Buni Hisar / Lule Burgas. Kjo e fundit ishte beteja më e madhe në Evropë midis Luftës Franko-Gjermane të 1870-1871 dhe Luftës së Parë Botërore. Otomanët u mblodhën në Chataldzha, linjat e fundit të mbrojtjes para Kostandinopojës. Një sulm nga bullgarët e rraskapitur dhe epidemikë u tërhoq në 17 nëntor kundër pozicioneve osmane atje dështoi. Të dy palët më pas u vendosën në një luftë llogore në Chataldzha.

Diku tjetër, ushtria serbe shkatërroi ushtrinë perëndimore osmane në Kumanovë më 23 tetor. Serbët pastaj vepruan kundër zvogëlimit të rezistencës në Maqedoni, Kosovë dhe përmes Shqipërisë, duke arritur në brigjet e Adriatikut në dhjetor. Marina greke i pengoi osmanët të transportonin përforcime nga Anadolli në Ballkan dhe pushtuan Ishujt Osmane Egje. Ushtria Greke përparoi në dy drejtime, duke hyrë në Selanik më 8 nëntor, dhe më tej në perëndim, duke e çuar qytetin e Janinës nën rrethim. Forcat malazeze u zhvendosën në Sanjakun e Novi Pazarit dhe rrethuan qytetin verior shqiptar të Scutari (Shkodër).

Otomanët nënshkruan një armëpushim me Bullgarinë, Malin e Zi dhe Serbinë më 3 dhjetor. Ndërkohë që operacionet ushtarake greke vazhduan. Në këtë kohë, Evropa Otomane ishte e kufizuar në tre qytetet e rrethuara të Adrianopojës, Janinës dhe Shkodrës, gadishullit Gallipoli dhe Thrakës lindore pas vijave Chataldzha. Si rezultat i rënies osmane, grupe të patriotëve shqiptarë, të mbështetur nga Austria dhe Italia, shpallën pavarësinë e Shqipërisë më 28 nëntor 1912. Ndërsa delegacionet nga aleatët e Ballkanit u përpoqën të negocionin një paqe përfundimtare me osmanët në Londër, një konferencë e Fuqisë së Madhe ambasadorët u takuan në Londër për të siguruar që interesat e tyre të mbizotëronin në çdo zgjidhje ballkanike.

Një grusht shteti më 23 Janar 1913 e ktheu në pushtet një qeveri të re turke në Kostandinopojë. Kjo qeveri ishte e vendosur të vazhdonte luftën, kryesisht me qëllim mbajtjen e Adrianopojës. Kjo qeveri denoncoi armëpushimin më 30 janar. Armiqësitë filluan, në dëm të osmanëve. Janina ra tek Grekët më 6 Mars dhe Adrianopoja te Bullgarët më 26 Mars.

Rrethimi i Shkodrës, megjithatë, shkaktoi komplikime ndërkombëtare. Austriakët kërkuan që ky qytet i banuar kryesisht nga shqiptarët të bëhej pjesë e shtetit të ri shqiptar. Nën presionin austrohungarez, forcat serbe që ndihmuan rrethimin malazez u tërhoqën. Malazezët vazhduan në rrethim, megjithatë, dhe arritën të marrin qytetin në 22 Prill. Një flotilje e Fuqisë së Madhe në brigjet e Adriatikut i detyroi malazezët të tërhiqeshin më pak se dy javë më vonë, më 5 maj.

Ndërkohë në Londër, bisedimet për paqen rezultuan në Traktatin paraprak të Londrës, të nënshkruar më 30 maj 1913 midis aleatëve të Ballkanit dhe Perandorisë Osmane. Me anë të këtij traktati, Perandoria Osmane në Evropë përbëhej vetëm nga një bandë e ngushtë territori në Thrakinë lindore të përcaktuar nga një vijë e drejtë e tërhequr nga porti Egje i Enos deri në portin e Detit të Zi të Midya.

### Lufta e Dytë Ballkanike

Gjatë Luftës së Parë Ballkanike, ndërsa bullgarët grindeshin me pjesën më të madhe të ushtrisë Osmane në Thrakë, serbët kishin pushtuar pjesën më të madhe të Maqedonisë. Mburojat austriake i ndaluan serbët të fitojnë portin Adriatik në veri të Shqipërisë ashtu siç dëshiruan. Serbët më pas u përpoqën të forcojnë qëndrimin e tyre ndaj Maqedonisë si kompensim për humbjen e bregdetit shqiptar. Grekët kurrë nuk kishin rënë dakord për ndonjë zgjidhje mbi Maqedoninë, dhe gjithashtu treguan se ata do të ruanin viset maqedonase që kishin pushtuar. Bullgarët mbetën të vendosur për të marrë këtë zonë. Armiqësia midis aleatëve për çështjen maqedonase u përshkallëzua gjatë gjithë pranverës së vitit 1913 nga shkëmbimet e shënimeve deri në të shtënat aktuale. Përpjekjet ruse për ndërmjetësim midis Bullgarisë dhe Serbisë ishin të dobëta dhe jo të frytshme.

Në natën e 29-30 qershor 1913, ushtarët bullgarë filluan sulmet lokale kundër pozicioneve greke dhe serbe në Maqedoni. Këto sulme u bënë sinjal për shpërthimin e luftës së përgjithshme. Kundërsulmet greke dhe serbe i shtynë bullgarët në kufijtë e tyre të para luftës. Ashtu si ushtria bullgare filloi të stabilizojë situatën, njësitë rumune dhe osmane pushtuan Bullgarinë. Rumunët u përpoqën të marrin Dobrudzhën jugore për të zgjeruar bregdetin e tyre të Detit të Zi dhe për të balancuar fitimet bullgare diku tjetër në Ballkan. Otomanët dëshiruan të rimarrin Adrianopojën. Ushtria Bullgare, tashmë e angazhuar rëndë kundër grekëve dhe serbëve, nuk ishte në gjendje t'i rezistonte rumunëve dhe osmanëve. Në këto rrethana, Bullgaria u detyrua për paqe. Me Traktatin rezultues të Bukureshtit, i nënshkruar më 10 gusht, Bullgaria humbi pjesën më të madhe të Maqedonisë në Greqi dhe Serbi, dhe Dobrudzha jugore në Rumani. Traktati i Kostandinopojës, nënshkruar më 30 shtator 1913 dhe i dha fund okupimit të shkurtër të Adrianopojës nga Bullgaria.

### Pasojat

Luftërat Ballkanike rezultuan me viktima të mëdha. Bullgarët humbën rreth 65,000 burra, grekët 9,500, malazezët, 3,000 dhe serbët të paktën 36,000. Otomanët humbën rreth 125,000 të vdekur. Për më tepër, dhjetëra mijëra civilë vdiqën nga sëmundja dhe shkaqe të tjera. Mizoritë e qëllimshme ndodhën në të gjithë territorin e luftës. Një tjetër pasojë e rëndësishme e Luftërave Ballkanike ishte tjetërsimi i Bullgarisë nga Rusia. Deri në vitin 1913, Bullgaria ishte klienti më i rëndësishëm i Rusisë në rajonin e Ballkanit. Afërsia e Bullgarisë me Kostandinopojën i dha Rusisë një bazë të vlefshme nga e cila të bënte presion mbi këtë zonë. Dështimi i diplomacisë ruse për të ndërmjetësuar mosmarrëveshjen bullgaro-serbe për territorin e Maqedonisë çoi në humbjen katastrofike të Bullgarisë në Luftën e Dytë Ballkanike dhe kthimin pasues të Bullgarisë në Aleancën e Tretë për kompensim. Kjo e la Serbinë si aleatin e vetëm të Rusisë në Ballkan. Kur dënimi austrohungarez kërcënoi Serbinë në korrik 1914, rusët u detyruan të mbronin Serbinë ose të humbnin plotësisht Ballkanin.

Ambiciet e malazezëve dhe serbëve në Shqipëri rritën shumë antipatinë austro-hungareze ndaj këtyre dy shteteve sllave të jugut. Qeveria Vjeneze u tregua e vendosur që fuqia serbe nuk duhet të rritet në Ballkan. Në tre raste të ndara, në dhjetor 1912, në prill 1913 dhe përsëri pas Luftërave Ballkanike në tetor 1913, austro-hungarezët u përplasën me serbët dhe malazezët për çështje shqiptare. Edhe pse lufta rezultoi në verën e vitit 1914 nga një ngjarje në Bosnje, konfliktet mbi Shqipërinë firmosën vendimin e austriakëve për të luftuar serbët. Lufta e Parë Botërore nuk ishte Lufta e Tretë Ballkanike; përkundrazi Luftërat Ballkanike ishin fillimi i Luftës së Parë Botërore. Konfliktet nacionaliste vazhduan në Evropën Juglindore nga 1912 deri më 1918. Problemet e nacionalizmit qëndruan ende në shekullin XXI. / *Përkthyer nga Literal Media*



BISEDË ME PROFESORESHËN KROATE, MAXIMILJANA BARAN I

# Arbënishtja e Zarës në Kroaci



Bisedoi: Mimoza
HASANI PLLANA

**Profesoreshë Baranćić, sa është e zhvilluar albanologjia në shtetin kroat, a mund të thuhet se ka trashëgimtar të denjë të albanologut të njohur Prof. Dr. Aleksandër Stipćević?**

MAXIMILJANA BARANĆIĆ: Në fakt nuk ekzistojnë studime albanologjike në Kroaci. Me sa di unë, gjer më tani, nuk ka trashëgimtarë të denjë të albanologut dhe ilirologut prof. dr. Aleksander Stipčević.

**Në studimet tuaja të fundit shohim një interesim më të madh për të folmen arbënishte, studimin e së cilës e keni zgjedhur për temën tuaj të doktoratuës, a mund të veçoni disa elemente karakterizuese të kësaj gjuhe?**

MAXIMILJANA BARANĆIĆ: Në studimet e mia doktorale kam vënë theksin në disa karakteristika kryesore të së folmes së dialektit tonë Arbënishtes. I kemi humbur disa zanore, p. sh: nuk kemi themi "thana" por "sana", me "than" por "san", derisa në gjuhën shqipe e kemi "th" ne e përdorim "s". Nuk ekziston ndonjë dallim kur ne përdorim "q" dhe "ç", dallim që ekziston edhe në gjuhën kroate. Ne përdorim diçka në mes, që në gjuhën kroate tingëllons si "č". E foljma jonë është e përafërt me dialektin shqiptar, e vetmja gjë është se pas shumë viteve ne kemi humbur shumë fjalë dhe po ashtu artikulimi ka ndryshuar lehtësisht. Por, kur unë flas, njerëzit në Kosovë dhe Shqipëri më kuptojnë plotësisht. Kur ata flasin me mua nganjëherë nuk i kuptoj, në veçanti nëse flasin shpejt.

**Përveç studimeve lidhur me të folmen arbëreshe, tanimë keni publikuar edhe studimin për ndikimet e fjalëve italiane në gjuhën arbëreshe, cilat janë rezultatet, sa ka arritur arbërishtja e sotme të ruaj origjinën e saj, që nga koha e emigrimit të komunitetit shqiptarë?**

MAXIMILJANA BARANĆIĆ: Kam shkruar një artikull dhe vitin e kaluar kam mbajtur një prezantim të atyre kërkimeve në Kosovë mbi ndikimin e gjuhës italiane në dialektin tonë Arbanasi. Ka shumë fjalë me origjinë italiane, të cilat kanë ardhur drejtpërdrejtë apo indirekt përmes dialektit kakavian, që vjen si rezultat i jetesës në komunitetit, me këta banorë. Arbënishtja është ruajtur në 35% të origjinës së saj, që nga koha kur ka ndodhur emigrimi nga mëmëdheu Shqipëria, duke qenë kjo një fenomen në vehte meqë nuk kanë ekzistuar shkolla, institucione etj.

**Keni botuar edhe një libër për mësimin arbënishtes, si u mirëprit nga komuniteti arbëresh?**

MAXIMILJANA BARANĆIĆ: Është pritur mjaft mirë nga komuniteti Arbëresh.

**A është i mjaftueshëm organizimi i konferencave, seminareve, tryezave që organizohen në Kosovë dhe në Shqipëri dhe sa ndihmojnë në zhvillimin dhe prezantimin e hulumtimeve të studiuesve të huaj lidhur me studimet e gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqiptare?**

MAXIMILJANA BARANĆIĆ: Besoj se konferencat, seminaret dhe tryezat e rrumbullakëta, që organizohen në Kosovë, Shqipëri, janë shumë të nevojshme dhe ndihmojnë shumë në zhvillimin, ruajtjen e hulumtimit akademik mbi gjuhën shqipe, letërsinë, kulturën; parë veçmas si dialogim debatues për nivelin ku kanë mbërritur kërkimet albanologjike, të gjuhës dhe letërsisë shqipe, në rajonin e Ballkanit dhe më gjerë. Unë kam marrë pjesë tre herë deri më tani në seminaret ndërkombëtare që mbahen në Kosovë.

**Çfarë mendoni për bashkëpunimin dhe përkrahjen që ofrojnë katedrat e gjuhës shqipe në Kosovë dhe Shqipëri?**

MAXIMILJANA BARANĆIĆ: Mendoj se bashkëpunimi dhe përkrahja në nivel universiteti në Kosovë dhe Shqipëri për studiuesit dhe studentët e huaj është e mirë dhe i nevojshëm, por megjithatë në lëmin e shkëmbimit të përvojave, gjithnjë ka nevojë për thellim dhe për plotësime.

**Sipas mendimit tuaj, sa është e njohur letërsia shqipe në Koraci?**

MAXIMILJANA BARANĆIĆ: Më duhet ta pranoj se letërsia shqipe nuk është mjaftueshëm e njohur në Kroaci, e prandaj ka nevojë për zgjerim të hapësirave të komunikimit.

**Sot, në mbarë Kroacinë kemi emra të njohur arbëreshë që përfaqësojnë kulturën e vendit në fusha të ndryshme, sa vlerësohen dhe respektohen nga shteti kroat?**

MAXIMILJANA BARANĆIĆ: Po, ekziston një respekt dhe vlerësim i meritu-ar tek shoqëria dhe institucionet kroate. Mund t'i përmend disa: nga familja Deshpalj kemi dirigjentin e njohur Pavle Deshpalj, vëllain e tij violinistin Valter dhe motrën e tyre Maja; Ennio Stipčević, muzikolog i njohur (djali i Aleksandër Stipčević); prof. dr. sc. Serdo Dokoza (historian që punon në Universitetin e Zarës) etj.

**Aktualisht, a jeni duke punuar në ndonjë projekt lidhur me studimet në fushën e albanologjisë?**

MAXIMILJANA BARANĆIĆ: Në këto momente jam duke punuar në fjalorin Kroat-Arbanas, ende duke punuar në detaje dhe shpresoj të publikohet këtë vit. Në maj planifikohet vënia në skenë e dramës "Nita" në teatrin kombëtar në Zarë (kombinim i gjuhës kroate dhe arbënishtes), ende vazhdoj me kursin e së folmes Arbënishte, që prej katër vitesh tashmë.

Maximiljana BARANĆIĆ, ka mbaruar studimet bazike në Fakultetin Filozofik, në Universitetin e Zagrebit, ndërsa studimet pasuniversitare për gjuhësi i mbaroi në Universitetin e Splitit. Aktualisht është duke punuar në disertacionin e doktoraturës me temën "Lexisi i të folmes së Arbanasit si reflektim i gjuhëve në kontakt". Punon si ligjëruese në Departamentin e Anglishtes në Universitetin e Zarës. Kërkimet e saj janë të përqëndruara në studimet e emrave, mbiemrave dhe pseudonimeve, veçanërisht nga Arbanasi, pastaj ka realizuar studime për identitetin etnolinguistik të arbanasëve, studime për poezinë, etj. Është e njohur për përkthimin e disa librave me poezi dhe zhanreve tjera letrare.

*Intervista u shkëput nga libri: Shtegtimi i shqipes në Europë. Autore: Mimoza Hasani Pllana. Boutes: OLYMP, Prishtinë, 2019./KultPlus.com*


i.
a cold, blowy day in early April, and a millio
thirteen. Winston Smith pushed open the glass
ons, turned to the right down the passage-way
of the lift. Nothing happened. He had just pr
hen a door at the end of the passage opened,
lled greens and old rag mats, and the aged pro
er and caretaker thrust out a grey, seamed face
sucking his teeth and watching Winston malignan
n't working," he announced at last.

# NICK RIPATRAZONE: A ËSHTË REDAKTIMI ART I HUMBUR?

*"Mësuesi i shkëlqyer është dhuratë. Redaktori i shkëlqyer është mrekulli."*

"Bagazh i panevojshëm", kështu i përshkroi Albert Erskine, redaktori i romanit "Suttree" të Cormac McCarthy-t, disa pjesë që në dorëshkrimin e dorëzuar nuk kishin ritëm. McCarthy e dëgjoi. Ai kaloi muaj duke e rishikuar dhe duke e shkurtuar librin. Erskine-t mund t'i besohej sepse kishte redaktuar veprën e tij që nga romani i parë në vitin 1966, "Përkujdesësi i pemishtes". Më përpara, ai kishte redaktuar veprat e William Faulkner-it. Karrierën si redaktor e kishte nisur në korrik, kur u bë bashkëthemelues i revistës letrare "The Southern Review".

Erskine ishte caktuar si menaxher biznesi, por menjëherë nisi të përzgjidhte dhe redaktonte prozën e revistës. Botoi tregime të shkrimtarëve Katherine Anne Porter, Caroline Gordon, dhe Eudora Welty. Vite më vonë, Erskine e ndihmoi Welty-in për të redaktuar romanin e saj të fundit, "Beteja të humbura". "Më priti në shtëpi si mysafire," kujtonte ajo, "hanim ushqim të mrekullueshëm dhe kalonim shumë këndshëm, dhe çdo ditë uleshim në tryezë për ta rishikuar dorëshkrimin e gjatë, rresht pas rreshti".

Erskine diskutonte dhe ndërmjetësonte për çdo fjali. Ai i tha Faulkner-it se përdorte sinonime të tepërta. Robert Penn Warren-it i kërkoi të përcaktonte llojin e gjinkallave që përmendte. Redaktoi romanin "Njeriu i padukshëm" të Ralph Ellison-it, dhe romancieri u ankua në një letër se "Erskine ka kohë që kërkon të përcaktoj se çfarë lloj romani është, dhe unë s'kam ç'të bëj". Erskine dhe Ellison-i e redaktuan së bashku romanin, duke e lexuar dorëshkrimin me zë të lartë, për të dëgjuar si tingëllonte. Redaktorët e tekstit i bëjnë të dyja, i inatosin por edhe i shpëtojnë shkrimtarët.

Dualiteti lind nga fjala: rresht. Rreshti nënkupton një domethënie të ndryshueshme por njëkohësisht tipografike. Një rresht është poetik dhe ka kuptim të fjalë për fjalshëm ku shpresa e qëllimit përmbushet në realitetin e faqes. Redaktimi rresht pas rreshti është bashkimi themelor midis shkrimtarit dhe redaktorit. Ky lloj redaktimi do të thotë se ne i heqim kontrollin dhe stilolapsin, dikujt tjetër. Është akt besimi dhe duhet të jetë i ndërsjelltë.

***

Joseph Heller u shpreh një herë për "The Paris Review" se redaktori i tij, Robert Gottlieb, mendonte se" "ishte turp" që lexuesit i duhej të priste shumë gjatë derisa të arrinte tek një kapitull i veçantë i romanit "Catch-22". Heller "shkurtoi afërsisht 50 ose 60 faqe nga fillimi vetëm që tek ai kapitull të arrihej më shpejt". Gottlieb-i, megjithatë, parapëlqeu të mos përfshihej në diskutimin publik të librave që redaktonte, sepse mendonte që "marrëdhënia e redaktorit me një libër duhet të jetë e padukshme".

Të gjithë ata që merren me këtë punë, e dinë se librat nuk janë sipërmarrje vetëm e një individi. Toni Morrison, e cila u redaktua gjithashtu nga Gottlieb-i, tha se ajo kurrë nuk ka shkruar "duke pasur Robertin në mendje, sepse kjo do të kishte ndikim shumë negativ tek ajo. Ai nuk është lexuesi ideal për krijimet e saj, por ishte redaktori ideal për të. "Redaktorët e tekstit nuk janë lexues në kuptimin publik; janë ushtrues privat të zejes, dhe profesioni i tyre mbështetet tek ndjenja e besimit ashtu si tek autoriteti i gjykimit. Gottlieb-i e quan marrjen e dorëshkrimit të një shkrimtari si veprim që bën "zhvendosjen emocionale". Ditët dhe javët që kalojnë para se autori ta rimarrë dorëshkrimin e redaktuar janë të shumta dhe pritja e gjatë, por shkrimtarët e dinë që ia vlen të presësh redaktorin e tekstit tënd, ia vlen ta durosh edhe ngarkesën emocionale.

Redaktorët e tekstit si përmbajtje (Line editors) shpesh ngatërrohen me

→

redaktorët e tekstit si formë (Copy editors). Të parët merren me stilin, gjuhën e përdorur në nivel fjalie dhe paragrafi, përqendrohet tek mënyra e përdorimit të saj për të komunikuar me lexuesin, nëse arrin të krijoj atmosferën, emocionin, dhe tonin. Ndërsa të dytët priren t'i japin dorën e fundit dhe ta përsosin veprën në një fazë të mëvonshme, por vetë kjo ngatërresë mes punës që duhet të bëj secili është shumë domethënëse. Ata duhet të merren me mangësitë në nivel teknik, drejtshkrimin, pikësimin, sintaksën, përputhjen e fakteve, vijimësinë e subjektit, mjedisit, tipareve të personazheve që shkrimi të jetë i qartë dhe i saktë.

George Witte, kryeredaktor i "St. Martin's Press", thotë se "shumica e redaktorëve të tekstit si formë bën punën e redaktorit të përmbajtjes". Redaktimi i formës bëhet pa krijuar marrëdhënie ndërveprimi me autorin, por në rastin e Erskine-t me Ellison-it, Gottlieb-it me Heller-in, redaktorët e përmbajtjes kanë marrëdhënie të drejtpërdrejtë me shkrimtarin. Sipas Witte ata janë "lexuesi ideal" i librit, sepse redaktojnë vepra të ndryshme të shkrimtarit për një kohë të gjatë, duke u shndërruar në "burimin e fitimeve, pikën e kontaktit, udhëzuesin gjatë procesit të botimit, në tifozin e zjarrtë dhe avokatin e tij, personin të cilit shkrimtari mund t'i shpreh shqetësimet, ose, ndoshta, edhe të takohet gjatë drekës apo ta shoqërojë në pije, ndonjëherë mik, dhe para së gjithash lexuesi më i vëmendshëm dhe më i ndershëm i veprës së një autori".

Redaktorët e përmbajtjes i tendosin fjalitë atëherë kur mugon tensioni dhe qartësia, por gjithashtu u japin frymëmarrje atëherë kur ato kufizohen. Përtej heqjes së frazave klishe, ata mënjanojnë fjalët e përdorura me tepri nga shkrimtari dhe disa struktura të caktuara fjalish. Redaktorët e tekstit ndihmojnë që fjalitë të ndërtohen në paragrafë dhe paragrafët të lexohen rrjedhshëm në faqe. Ata mbajnë të bashkuar syrin dhe veshin e shkrimtarit. Por një redaktor teksti, i cili ka alergji nga lëvdatat, dhe vetëm mban në dorë një çekiç, mund të shkatërrojë jo vetëm një dorëshkrim. Akoma më keq, mund të lëndojë një shpirt.

***

Dorëshkrimet dhe shpirtrat shpesh shpëtohen nga redaktorët e tekstit si përmbajtje. Kur Ernest Hemingway i nisi në tetor 1949 një letër Charles Scribner-it, ai ishte në gjendje të mirë shpirtërore: "Në djall shkrimi sot". Pastaj shprehet për redaktorin Maxwell Perkins dhe romancierin Thomas Wolfe: "Nëse Max-i nuk do të kishte shkurtuar dhjetë tonë pleh nga romani i Wolfe-it, të gjithë do ta dinin që pas librit të parë se sa shkrimtar i dobët është. Por tani nuk e di kush, vetëm miqtë e afërt si unë ose ata me të cilët pi verë. "Vite më parë, Hemingway e kishte paralajmëruar Perkins-in për personalitetin e tij: "Ju lutem ta dini se kur jam i zhurmshëm, i hidhur, i vrazhdë, nuk bindem dhe jam mosbesues, atëherë në të vërtet jam shumë i arsyeshëm dhe kam besim të madh, kam besim absolut tek ju".

Në disa ese për "The Guardian", Blake Morrison dhe Alex Clark kanë shkruar shënime elegante për redaktime të tilla teksti. Morrisoni e identifikon periudhën 1912-1925 si "epokën e artë të redaktimit", por mendon se arti i redaktimit të kujdesshëm të tekstit në fund të fundit pësoi kishte një vdekje praktike bashkëkohore. Ai thotë se shumica e botuesve mendojnë se redaktorët duhet të jenë më të shkathët tani; duhet të jenë "persona të gjithanshëm, të përfshirë në promovime, veprimtari publicitete dhe në procesin e shitjes". Agjentët letrar kanë zëvendësuar redaktorët; agjentët "u ofrojnë autorëve qëndrueshmëri", ndërsa redaktorët "janë shtegtues, zhvendosen nga një shtëpi botuese tek tjetra". Clark i bën jehonë kësaj ndjenje, duke pyetur veten "nëse imazhi i redaktorit idengulitur pas fjalës, i zhytur në tekstin e një dorëshkrimi, me stilolaps të kuq në dorë, i ka hapur rrugë sipërmarrësit të zot që i përshtatet kapriços më të fundit të tregut, i cili di më shumë çfarë të shkruaj në Twitter se sa çfarë është metafora".

E vërteta dhe historia janë të ndërlikuar. Autori i letërsisë fantastiko-shkencore Samuel Delany pasi reflektoi mbi karrierën e tij që nisi në vitin 1962 dhe vazhdon deri sot, arriti në përfundimin se ai ka pasur vetëm një redaktor të vërtetë teksti letrar, Ron Drummond-in. Delany mendon se "leximet maratonë" që bëjnë redaktorët e shtëpive të ndryshme botuese "priren t'i topisin edhe ndjeshmëritë më të holla të nevojshme për të hyrë brenda një teksti, për t'i ndjerë ato nga brenda në mënyrë që të jepen sugjerime të dobishme për përmirësime të cilat shkrimtari i dëgjon dhe pastaj reagon". Mënyra e tyre e leximit është një vendim: ky libër funksionon, do të shitet. Për Delany-n, kjo mënyrë leximi është e ngjashme me stilin kritik që përdoret në një seminar shkrimi krijues, në të cilin "librat kategorizohen në përgjithësi sipas efektit që krijojnë, më shumë se sa në lidhje me të veçantën dhe ndjeshmërinë e arsyetuar. Këto lexime kritike nuk janë të pavlefshme, por ato "marrin parasysh kujtesën e tekstit, jo përvojën aktuale të leximit të tekstit e cila është ajo çfarë shkrimtari e modelon gjithmonë pak a shumë me zotësi ndërsa shkruan".

Ajo që sugjeron Delany, dhe çfarë duket e vërtetë për Erskine-n, Gottlieb-in dhe redaktorët e tjerë të tekstit si përmbajtje që vazhdojnë të redaktojnë, është të jesh redaktori-lexues, i vetëm, kritik, i cili zhvillohet dhe rritet me shkrimtarin. Në vend që ta shohim redaktimin e tekstit si art i harruar, të konsumuar pa mëshirë nga biznesi i librit, duhet ta shohim si privilegj, një dhuratë, të cilën e kanë shijuar disa shkrimtarë, por jo pjesa më e madhe e tyre. Rust Hills, redaktori i prozës se "Esquire" para dhe pasi Gordon Lish tha se "midis të mësuarit të tjerëve shkrimin krijues dhe redaktimi të revistave letrare ka shumë dallime të çuditshme", por "të dyja kanë të njëjtin qëllim përfundimtar të çuditshëm: përpjekjen që të bësh dikë tjetër të krijojë një rrëfim të mirë". Redaktori i tekstit njësoj, si mësuesi dhe udhërrëfyesi, ndihen si një metaforë e dobishme, dhe ajo që e kam përjetuar vetë.

Shigjetat e lakuara të bëra me stilolaps mbushin faqen. Kryqet fshijnë fjalët shtesë. Pyetjet rreshtohen në skaj të faqes. Njollat e zeza duken kudo në dy faqe, me një shpjegim: "ma harxhove bojën!" Redaktimet me ngjyrë blu nuk janë më të këndshme: "e panevojshme"; "forma pësore"; "ku jemi këtu?" Një shënim përmbyllës shkruhet në pjesën e pasme të dy faqeve, duke u hapur me disa lëvdata të shkurtra, por më pas përkapin shpirtin e historisë së rrëfyer.

Mësuesi i shkëlqyer është dhuratë. Redaktori i shkëlqyer është mrekulli. Jayne Anne Phillips i kishte të dyja. Kopjet e saj të mbushura me shënime të dorëshkrimeve të mia ishin mësime të përmbledhura në aspektin e formës dhe funksionit. Ulesha në zyrën e saj në Rutgers-Newark dhe merresha me çdo vërejtje. Ajo kishte leksione me studentët një orë para seminareve tona. Dhe bisedat tona nuk ishin biseda sipërfaqësore; Jayne Anne bëri vërtetë punë të mirë. Ajo u mor me të gjitha tregimet, fjali pas fjalie, paragraf pas paragrafi dhe faqe pas faqeje. Ajo më foli për tregimet e mia, skenat jo të arrira, skenat ambicioze, si çështje që kishin rëndësi për të. Ne e respektonim. Ajo na trembte, jo sepse tregohej e padrejtë, por sepse ishte shkrimtare kaq e talentuar.

Ashtu si Jayne Anne, profesoresha ime e letërsisë në universitet ishte rritur në Virxhinian Perëndimore, dhe ne e lexuam prozën e saj të shkurtër përpara vizitës në kampin e universitetit por më tërhoqi "Biletat e zeza". Libra të tjerë do të më rrëmbenin: "Në zemrën e zemrës së vendit" i William H. Gass-it, romani "Mariette e dalldisur" e Ron Hansen-it, përmbledhja me tregime "Britmë dhe vaj" e James Alan McPherson-it, por "Biletat e Zeza" ishte i pari ndër to. Të gjithë shkrimtarët kanë nevojë për një libër që i bën të besojnë se fjalët kanë rëndësi. Libri i saj më bëri ta besoj këtë. "E di, hasa rrugës këtë fermerin plakush e të poshtër në një bar mbrëmë. Më tha se po e shiste kamionin për dy kacidhe dhe se mund të veja në La Rosa për ta marrë". Fjalitë e para të romanit të Winston Groom-it "El Paso" më tërhoqën aty për aty vëmendjen. Fjalitë e saj më goditën, me detaje që vërshonin: "Duke ecur në oborrin e pluhurt, nëpër goma të vjetra dhe ndanë sustës së një shtrati të kalbur, një mushkë rrinte e lidhur tek një pompë afër kotecit, dhe ai u ndal më në fund tek njëfarë makine Shevrolet e viteve 50-të, me një shtrojë të sajuar ku ishin vendosur kafazë pulash. Kryqe dhe një kukull e nxirë, çelësa të varur në një kordele flokësh". Ishte një botë e krijuar me detaje të sakta dhe të pazakonta.

Disa vjet më vonë, kur mësova se Jayne Anne kishte themeluar programin universitar të arteve në Rutgers-Newark, u detyrova të aplikoja. Ajo ishte drejtoreshë e programit dhe jepte mësim në seminaret e shkrimit krijues. Më pëlqente tej mase të isha në orët e saj të mësimit. Lexuam "Syri më blu" të Toni Morrisonit, "Fat City" të Leonard Gardner-it, dhe ajo na tregoi këngët e rreshtave të tyre. Rreshtat ishte fjala që përdorte për të përshkruar fjalinë. Pavarësisht nga mënyra si ishin ndërtuar, fjalitë duhej të ishin drejtvizore dhe të rrjedhshme. Kryefjalë, folje, kundrinor.

Një mësues i shkrimit krijues mund të të mësojë shumë gjëra, por më e rëndësishmja është përkimi i ushtrimit dhe misterit. Jayne Anne na mësoi teknikën pa e asgjësuar artin. Kohët e fundit e pyeta për metodën e saj të leximit të dorëshkrimeve të studentëve. "Epo atëherë më duhet të të flas për redaktimin e tekstit si përmbajtje, sepse unë e bëj me intuitë," thotë ajo. "E shoh një rresht dhe e di menjëherë se çfarë ndryshimesh duhen bërë, çfarë duhet fshirë, frazat që duhen hequr, çfarë e bën më të mirë, më të fortë, më të thukët. Qartësia, kuptimi, domethënia, siç ka thënë Frank Conroy (gjithashtu një mësues i redaktimit të tekstit) për studentët e tij të universitetit. Natyrisht, është më e vështirë të redaktosh veten, por (nganjëherë) s'e pengoj dot veten të mos lexoj atë që është botuar me syrin e redaktorit".

Jayne Anne ishte mësuesja e parë që më bindi se të gjitha redaktimet e vërteta ndodhin në faqen e shtypur. Është e nevojshme ta prekim një dorëshkrim, ta ndiejmë atë si të vërtetë, përpara se ta bëjmë diçka më të mirë. Ajo thotë se "studentët zakonisht e kuptojnë shumë shpejt nëse një redaktim teksti është i dobishëm. Është sikur rreshti gjen vendin e vet ose sinkronizon ritmin. Shkrimtarët e vërtetë fillojnë ta brendësojnë atë vëmendje ndaj rreshtit, ndaj një lloj fraze muzikore, ndaj kumbimit të rrokjes, ndaj çastit kur duket qartë se duhet vënë pikë".

Metoda që ajo përdor më çon sërish tek zyra e saj në Newark, ku mësova se redaktimi nuk është diçka që ne bëjmë tek ajo që është shkruar; redaktimi është shkrim. "Gjatë redaktimit depërton tek paragrafi, historia, gjatë gjithë romanit", – thotë Jayne Anne, "dhe rreshti në fletë është themeli i të gjithave, plotësisht i dukshëm dhe i pranishëm, pavarësisht sa i errët është qëllimi, i cila shpesh është vetëm ajo që ne mendojmë se dimë për atë që po përpiqemi të shkruajmë".

"Qëllimi mund ta bëjë një bisedë interesante, por nuk shkruan një libër. Shumë shpesh të shkruarit është shkëndijues, tingëllues, erëmues, shkëlqimtar, me qëllimin për të na tërhequr më fort si shkrimtarë, por ne e bëjmë këtë nëpërmjet rreshtit". Kur merrja sërish dorëshkrimet nga Jayne Anne, faqet ishin të mbushura me shënime, ato ngjanin më të rënda, të vjetëruara. Ajo hynte në rrëfimet e mia nëpërmjet rreshtave, dhe i jam përgjithmonë mirënjohës. Saxe Commins, redaktori për një kohë shumë të gjatë i Faulkner-it, e ndihmoi romancierin si profesionalisht ashtu edhe personalisht. Përshkrimi i Faulkner-it për marrëdhëniet e tyre përkap lidhjen e ndërlikuar midis shkrimtarit dhe redaktorit: "Asnjëherë s'kishim të njëjtin mendim, por gjithmonë synonim të njëjtën gjë".

*Revista letrare "LitHub", shkurt, 2019./exlibris.al/*
*Përktheu: Granit Zela*

E rrallë

## Mbishkrim interesant në qiell mbi Sydney, aeroplani “shkruan” një paralajmërim: Pastroni duart



Në qiell mbi Australinë është shfaqur një mbishkrim “Pastroni duart”, si këshillë për qytetarët që duhet të ndërmarrin masa preventive në luftën kundër përhapjes së koronavirusit. Kjo pamje e pazakontë është filmuar në Sydney, ku një aeroplan i vogël lëshoi një lloj tymi me të cilin i bëri shkronjat.

FOTO E DITES



Personeli mjekësor në Italinë Veriore shihet duke punuar edhe në tenda, duke dhënë ndihmë për të prekurit me koronavirus. /AP/

E jashtëzakonshme

## Ylli në formë loti, një formë e tillë që ka mahnitur shkencëtarët

Një yll që nuk është parë kurrë më parë, që është në formë loti dhe pulson vetëm në njërën anë, është zbuluar nga astronomët. Ylli, i quajtur HD74423, qëndron 1.500 vite dritë larg dhe është pjesë e një sistemi binar me një xhuxh të kuq, për të cilin studiuesit thonë se ai është shkaku i formës së ‘prishur’ dhe ‘pulsuese’ të formës së pazakontë që ka ylli. Yjet pulsues janë një lloj ylli i ndryshueshëm që rritet dhe zvogëlohet në madhësi në mënyrë periodike, duke shkaktuar një ndryshim në shkëlqimin e tyre për shkak të ndryshimeve fizike brenda yllit.



## BARSOLETA E DITËS



Vjen gruaja e nervozuar në shtëpi.
- Zemër, do ta padis taksistin në gjykatë. Sot, në dy raste, për pak sa nuk më vrau.
- Mos u ngut zemër. T’i japim edhe një rast.

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Në ora 18:00

### Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno







Në ora 18:00

### Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min

**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser’Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.

**Regjia:** Jake Kasdan

Çdo natë në ora 20:00

### STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj

**Regjia:** J.J. Abrams







Çdo natë në ora 22:30

### THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI** Shqetësimi i tepërt mund t’ju shkaktojë ankth. Partneri/partnerja juaj do të tregojë kujdes të veçantë ndaj jush.



**DEMI** Disa persona mund të ndikojnë në vendimet tuaja. Mos u mbështesni maksimalisht tek të tjerët dhe mësohuni që të përballeni vetë me çështje të rëndësishme.



**BINJAKËT** Mbështetja e madhe nga anëtarët e familjes suaj do t’i sjellë rezultatet e dëshiruara. Ekziston mundësia të takoni një mik të vjetër.



**GAFORRJA** Përpiquni ta përmirësoni në përgjithësi shëndetin tuaj për një jetë më të mirë. Mos jepni para hua gjatë kësaj jave.



**LUANI** Do të ndiheni të mbushur plot energji. Është dita e duhur për t’i rregulluar marrëdhëniet me personat që keni pasur probleme kohët e fundit.



**VIRGJËRESHA** Besimi në vetvete është thelbësor për personat e kësaj shenje që luftojnë me sëmundje kronike.



**PESHORJA** Miqtë do të tregohen mbështetës ndaj jush dhe do t’ju bëjnë të ndiheni të lumtur. Ka gjasa të përfundoni të gjitha detyrat.



**AKREPI** Ekziston mundësia të mos ndiheni mirë nga ana shëndetësore. Një rritje e papritur e shpenzimeve tuaja mund t’ju sjellë shqetësime.



**SHIGJETARI** Jeta në familje do të jetë e paqtë. Është dita e duhur për biznesmenët e kësaj shenje për të zhvilluar negociata me klientë të rinj.



**BRICJAPI** Përpiquni që idetë tuaja të reja t’i ktheni në realitet. Ekziston mundësia e përmirësimit të gjendjes financiare.



**UJORI** Përpiquni ta kuptoni më mirë njëri-tjetrin në çift. Vetëm kështu do të mund të keni harmoni mes jush.



**PESHQIT** Ekziston mundësia të shpenzoni një shumë të konsiderueshme parash, çfarë do të jetë domosdoshmëri.

# Maluma reagon pas anulimit të koncerteve nga frika e koronavisurit



Maluma mori vendimin për t'i shtyrë koncertet në Greqi dhe Shqipëri për shkak të frikës së përhapjes së koronavirusit. Nga Greqia, këngëtari spanjoll ka pohuar se ndihet i trishtuar për marrjen e këtij vendimi. Maluma u shpreh se anulimi i koncerteve u bë për të mirën e shëndetit të qytetarëve dhe ekipit të organizatorëve. "Jam pak i trishtuar sepse koncertet që do të mbaja në Greqi do të shtyhen. Së shpejti do t'u japim datat e reja kur do të zhvillohen. Dëshiroja shumë t'i bëja këto koncerte, por për shkak të koronavirusit duhet t'i shtynim", ka shkruar ai në rrjetet sociale.

# Aktori i njohur hollivudian dhe bashkëshortja preken nga koronavirusi



Aktori amerikan, fitues i çmimit Oskar, Tom Hanks dhe bashkëshortja e tij Rita Wilson janë infektuar me koronavirus. Çifti ndodhet Australi dhe pasi u janë nënshtruar analizave kanë rezultuar pozitiv. Lajmi është bërë me dije nga vetë aktori i njohur me anë të një postimi në "Twitter". "Rita dhe unë jemi në Australi. Na u shfaqën disa simptoma si lodhje, të ftohur me dhimbje në trup. Rita kishte ethe që shkonin e vinin edhe temperaturë, por jo shumë të lartë. Më pas iu nënshtruam testit të koronavirusit, i cili rezultoi pozitiv. Po tani çdo të bëjmë? Po ndjekim çdo gjë sipas protokollit. Do të jemi në izolim për kohën sa duhet", ka shkruar aktori i njohur 63-vjeçar.









# Bradley Cooper dhe Irina Shayk, prindër "në distancë" për të voglën Lea

Kanë mbajtur një raport shumë të mirë miqësie për të mirën e vajzës së tyre, pavarësisht se nuk janë më bashkë prej disa kohësh. Bradley Cooper dhe Irina Shayk po jetojnë jetën e tyre si prindër të ndarë. Vogëlushja Lea i është besuar 50 për qind secilit prej tyre dhe të dy kanë vendosur të jetojnë në Nju Jork, për të pasur mundësi të qëndrojnë me vajzën sipas një kalendari të caktuar. Kështu Lea nga një shëtitje në park me mamin më pas shihet sërish duke shëtitur me babanë e saj.

# Gjendet e vdekur ish-partnerja e Floyd Mayweather




Josie Harris, nëna e tre fëmijëve të superyllit të boksit Floyd Mayweather, është gjetur e vdekur në makinën e saj në Kaliforni. 40-vjeçarja u gjet pa ndjenja në rrugën e shtëpisë së saj, në Valencia, Los Angeles Count, ka njoftuar mjekja ligjore, raporton BBC. Deri më tani asnjë informacion tjetër nuk është publikuar në lidhje me shkakun e vdekjes.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Aktivitetet sportive zhvillohen pa shikues

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka njoftuar se, me vendim të Qeverisë së Kosovës, të gjitha aktivitetet sportive mund të zhvillohen, por pa praninë e shikuesve. Ndërsa Federata e Hendbollit e Kosovës ka kërkuar nga Federata Evropiane e Hendbollit (EHV) të shtyhen ndeshjet kualifikuese në mes të Kosovës dhe Bjellorusisë në konkurrencën e vashave

EPOKA E RE Veton ZYMBERI



PRISHTINË, 12 MARS - Përhapja e shpejtë në Evropë e COVID-19, i njohur si Corona Virus, ka bërë që institucionet e Kosovës të marrë masa parandaluese në funksion të mbrojtjes nga ky virus. Këto masa janë marrë edhe në sport, ku aktivitetet sportive do të zhvillohen, por pa praninë e shikuesve. "Këto masa të cilat janë ndërmarrë nga MKRS-ja janë në kuadër të pikës 5 të vendimit të Qeverisë së Kosovës. Konkretisht, kjo masë nënvizon se aktivitetet publike dhe jopublike mund të zhvillohen të mbyllura/pa praninë e publikut si: ngjarje/tubime sportive, tubime, koncerte, konferenca, tryeza të rrumbullakëta deri në një vendim tjetër", thuhet në njoftimin e MKRS-së.

Federata e Futbollit e Kosovës ka njoftuar se ndeshjet e futbollit në ligën e seniorëve do të zhvillohen pa praninë e shikuesve, kurse ligat e juniorëve dhe grupmoshave të reja pezullohen përkohësisht. "Të gjitha ndeshjet e futbollit në Kosovë në kategorinë e seniorëve do të zhvillohen pa praninë e publikut deri më 27 mars 2020, derisa ligat e juniorëve dhe grupmoshave të reja pezullohen përkohësisht (deri në një vendim të ri)", thuhet në njoftimin e FFK-së.

Në stadiume, gjatë zhvillimit të ndeshjeve, do të jenë të pranishëm vetëm stafet e skuadrave, zyrtarët e FFK-së, zyrtarët e klubeve, zyrtarët policorë dhe përfaqësuesit e mediave. Klubet organizatore të ndeshjeve udhëzohen që ta bëjnë vendosjen e dezinfektuesve të duarve në zhveshtore. Po ashtu, si masë parandalimi ndaj koronavirusit, ashtu sikurse në vendet e tjera evropiane, rekomandohet që futbollistët dhe stafet e skuadrave të mos e bëjnë përshëndetjen e zakonshme të dhënies së duarve në fillim dhe në fund të ndeshjes", thuhet në njoftimin e FFK-së.

Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) ka njoftuar se ndeshjet do të zhvillohen me dyer të mbyllura, pa praninë e publikut. "Qëndrimi në palestër, krahas lojtarëve/eve, shtabeve teknike, u lejohet edhe zyrtarëve të klubeve, ku numri i tyre nuk guxon të jetë më i madh se 15 për secilin klub. Po ashtu, të pranishëm nga zyrtarët e FBK-së në palestra, duke përfshirë këtu gjyqtarët e vëzhguesin, numri i tyre në total nuk bën të jetë më i madh se 10 në një ndeshje basketbolli. Të pranishëm në palestër duhet të jenë edhe pjesëtarë të Policisë së Kosovës, ndërsa në ndeshjet e Superligës së Kosovës edhe pjesëtarët e sigurimit privat. Mediat që dëshirojnë t'i përcjellin ndeshjet duhet që së pari të marrin leje nga FBK-ja", thuhet në njoftimin e FBK-së.

Bordi i Federatës së Hendbollit të Kosovës menjëherë pas vendimit të qeverisë ka njoftuar se ndeshjet e hendbollit në do të zhvillohen pa praninë e shikuesve në palestra. Po ashtu, FHK-ja ka kërkuar nga Federata Evropiane e Hendbollit (EHV) të shtyhen ndeshjet kualifikuese mes Kosovës dhe Bjellorusisë në konkurrencën e vashave për shkak të koronavirusit. Ndeshja në mes të Kosovës dhe Bjellorusisë ishte planifikuar fillimisht të luhet më 25 mars në Prishtinë, kurse ndeshja tjetër më 29 mars në Minsk. "FHK-ja është në komunikim intensiv me EHF-në dhe pritet që të aprovohet kërkesa jonë. Nëse kërkesa aprovohet, ndeshjet luhen në javën e parë të qershorit", thuhet në njoftimin e publikuar nga Federata e Kosovës.

## Formula 1 anulon garën në Australi

Formula 1 ka vendosur që ta anulojë garën hapëse të këtij edicioni. Gjatë gjithë ditës është diskutuar për Grand Prix Australia të Formula 1, pasi piloti i McLaren është prekur nga koronavirusi. Tutje, edhe Lewis Hamiltoni shprehej i shokuar me Formula 1 për vendimin që gara të mbahej. Duket se me gjithë këto, F1 ka vendosur më në fund të intervenojë. Raportimet e fundit konfirmojnë se Grand Prix Australia është anuluar. Vendimi është marrë pas një takimi që zgjati 2 orë e gjysmë, mes drejtuesve të F1. Mbetet të shihet se për kur do të caktohet kjo garë.

## SHKURT

### UEFA pezullon ndeshjet kualifikuese të U17, U19 dhe turnetë Elite Youth

UEFA ka vendosur t'i pezullojë të gjitha aktivitetet për Elite Youth dhe ndeshjet kualifikuese për U17 dhe U19 deri në një afat të pacaktuar pas situatës së krijuar në shumicën e vendeve evropiane nga përhapja e shpejtë e koronavirusit. "Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, i cili është në kontakte të vazhdueshme me drejtuesit e UEFA-s, ka bërë me dije se të martën në mesditë do të mbahet një video-konferencë e përbashkët e presidentit Aleksandër Çeferin me të gjithë presidentët e 55 federatave anëtare të UEFA-s, ku do të diskutohet për situatën e krijuar dhe do të merret vendimi lidhur me rrjedhën e mëtejshme të kampionateve dhe të gjitha kompeticioneve të tjera për klube dhe kombëtare, duke përfshirë edhe 'Euro 2020' pas përhapjes së shpejtë të koronavirusit", thuhet në njoftimin e FFK-së.

### Trumpi kërkon anulimin e Lojërave Olimpike

Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, ka folur lidhur me koronavirusin dhe Lojërat Olimpike. Lojërat Olimpike 2020 planifikohet të zhvillohen në Tokio, por duket se gjithçka mund të shtyhet. Olimpiada planifikohet të mbahet nga 24 korriku deri më 9 gusht. I këtij mendimi është edhe presidenti i ShBA-së, vendi i të cilit deri më tani ka anuluar NBA dhe MLS. Sipas 'Reuters', Trump thotë se edhe Lojërat Olimpike duhet të shtyhen për vitin 2021.

### Rugani dhe Gabbiadini me koronavirus

Pas mbrojtësit të Juventusit, Daniele Rugani, edhe sulmuesi i Sampdorias, Manolo Gabbiadini, ka testuar pozitiv me koronavirus. "Sampdoria njofton se futbollisti Manolo Gabbiadini është testuar pozitiv me koronavirusin COVID-19. Ai ka temperaturë pak, por është mirë. Klubi ka aktivizuar të gjitha procedurat e izolimit siç kërkohen me ligj", është thënë në komunikatë të klubit.

### Ronaldo mbetet në Portugali në karantinë

Dalja pozitive me koronavirus, i mbrojtësit të Juventusit Daniele Rugani, ka bërë që Cristiano Ronaldo të mbetet në Portugali, ku do t'i nënshtrohet karantinës deri në momentin që t'o bëjë edhe vetë analizat. Ylli portugez ishte kthyer në vendlindje për ta vizituar të ëmën e sëmurë, por tani e ka të pamundur të rikthehet në Torino, të paktën derisa të konfirmohet nëse është i prekur apo jo nga virusi që është shndërruar në një pandemi tashmë. Vetë Ronaldo ishte shprehur me miqtë e tij edhe më herët se nuk preferonte të rikthehej në Itali, para se të normalizohej situate dhe se do të qëndrojë në Madeira pranë familjes për të shmangur rrezikun e prekjes nga koronavirusi.

## Ndërpritet kampionati i futbollit në Shqipëri

TIRANË, 12 MARS - Federata Shqiptare e Futbollit ka njoftuar se do të ndërpritet kampionati i futbollit në Shqipëri. Përmes një njoftimi për shtyp, FShF-ja bën të ditur se për shkak të përhapjes së koronavirusit, të gjitha aktivitetet sportive do të pezullohen në mbarë Shqipërinë. "Komiteti Ekzekutiv i Federatës së Futbollit ka ndjekur nga afër dhe me prioritet ecurinë e situatës në vendin tonë pas rasteve të shfaqura me COVID-19. Nisur nga përshkallëzimi i kësaj situate dhe duke ndier përgjegjësi maksimale për të gjithë personat e përfshirë në jetën futbollistike në vend si dhe pas propozimit të Komitetit të Emergjencave në FShF, Komiteti Ekzekutiv vendosi pezullimin e të gjitha aktiviteteve futbollistike. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë deri në një komunikim tjetër të Federatës së Futbollit. Lidhur me të gjitha aktivitetet ndërkombëtare futbollistike, ku edhe Shqipëria është pjesëmarrëse, ditën e martë në orën 13:00 UEFA do të organizojë një video-konferencë me të 55 federatat anëtare për ta marrë vendimin lidhur me ecurinë e të gjitha aktiviteteve futbollistike evropiane", thuhet në njoftimin e FShF-së.

# Boksierët në Londër synojnë normat olimpike 'Tokio 2020'



PRISHTINË, 12 MARS - Përfaqësuesja e Kosovës në boks është nisur të enjten drejt Londrës, ku prej 14-24 mars 2020 do të mbahet turneu kualifikues evropian për Lojërat Olimpike "Tokio 2020". Ekspedita e boksit përbëhet nga boksierët: Donjeta Sadiku, Patriot Behrami, Shpëtim Bajoku dhe Besart Pireva, trajnerë: Shefki Bogujevci e Besim Brahimi, si dhe gjyqtari ndërkombëtar Latif Demolli, njëherësh zëdhënës i FBOXK-së. Boksierët e Kosovës synojnë të fitojnë një vend që siguron kualifikimin për në Lojërat Olimpike "Tokio 2020". Kampiones së tanishme ballkanike, Donjeta Sadiku, e cila garon në kategorinë deri në 60 kilogramë, do t'i mjaftonte pozita e gjashtë për ta siguruar 'biletën' për në Tokio 2020. Falë mbështetjes financiare të Komitetit Olimpik të Kosovës, Donjeta, si bursiste e KOK-ut, ishte përgatitur në kampin ndërkombëtar në Trabzon të Turqisë. Ajo më herët kishte deklaruar se në Londër synon pozitën e parë.

Patriot Behrami, i cili në Lojërat Evropiane Minsk 2019 doli i pesti, do të garojë në kategorinë - 69 kilogramë. Edhe atij, njësoj si Sadikut, do t'i mjaftonte pozita e gjashtë për kualifikim në Tokio 2020. Mënyrë të njëjtë kualifikimi ka edhe Besart Pireva në kategorinë deri në 75 kilogramë. Sigurimin më të lehtë të normës e ka Shpëtim Bajoku, kategoria -63 kilogramë. Atij i mjafton të kualifikohet në çerekfinale dhe ta sigurojë "vizën" për në Lojërat Olimpike. "Boksierët janë në formë të mirë. Ata kanë pasur disa përgatitje dhe mendoj se janë maksimalisht të përgatitur. Nesër hedhet shorti dhe shpresojmë edhe në fat. Me dy deri në tri fitore boksierët e sigurojnë kualifikimin në Lojërat Olimpike", ka thënë zëdhënësi i FBOXK-së, Latif Demolli. Garat në Londër organizohen nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar, pas pezullimit të bërë Federatës Ndërkombëtare të Boksit (AIBA). Mundësinë e dytë për kualifikim në LO Tokio 2020 boksierët tanë e kanë në Paris, ku prej 13-24 maj 2020 mbahet turneu kualifikues botëror.

# Ylli i NBA-së me coronavirus, pezullohen të gjitha ndeshjet

OKLAHOMA, 12 MARS - Coronavirusi ka prekur edhe NBA-në. Basketbollisti i Utah Jazz, Rudy Gobert, ka rezultuar pozitiv, duke bërë që ndeshja ndaj Oklahomës të mos zhvillohet. Nuk është luajtur edhe takimi mes Sacramento-New Orleans, që do të niste në të njëjtin orar si sfida e Jazz. Ndërkohë që janë luajtur vetëm 4 ndeshje, që kishin nisur më herët. Drejtuesit e NBA-së kanë lëshuar një komunikatë për pezullimin e menjëhershëm të aktivitetit. "NBA pezullon aktivitetin e saj pas ndeshjeve të sotme. Një lojtar i Utah Jazzit ka rezultuar pozitiv me coronavirus. Rezultati i testit është marrë pak minuta para fillimit të ndeshjes", thuhet me pak fjalë në deklaratën për media të NBA-së. Në ato momente lojtari nuk ka qenë në stadium, por mësohet se ndodhet në karantinë. NBA ka vendosur të pezullojë pa afat ndeshjet deri në një moment të dytë. Të gjithë lojtarët e Jazz do t'i nënshtrohen testit të coronavirus si dhe disa gjyqtarë që kanë gjykuar këtë skuadër.

**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| Philadelphia - Detroit | 124-106 |
| Atlanta - New York | 131-136 |
| Miami - Charlotte | 98-109 |
| Dallas - Denver | 113-97 |
| Oklahoma - Utah Jazz | (e shtyrë) |
| Sacramento - New Orleans | (e shtyrë) |

## SHKURT

### Pezullohet për dy javë La Liga

La Liga është pezulluar për dy javë pasi lojtarët e Real Madridit dhe stafi janë vendosur në karantinë për 15 ditë pasi një lojtar i basketbollit i Realit është testuar pozitiv me koronavirus, njoftojnë mediumet spanjolle të enjten. Pas një takimi mes Federatës së Futbollit të Spanjës, Unionit të Lojtarëve të Spanjës dhe La Ligas është vendosur të pezullohet për dy javë elita e futbollit spanjoll. Ndeshjet ishte paraparë të luheshin pa shikues. "Ne do ta rivlerësojmë situatën pas kompletimit të karantinës në klubin e prekur", është thënë në komunikatë të La Ligas.

### Zaccheroni: Ibra, si Messi dhe Ronaldo

Ish-trajneri i Milanit, Alberto Zaccheroni, e ka krahasuar sulmuesin Zlatan Ibrahimoviq me dy yjet e futbollit botëror, Lionel Messi dhe Cristiano Ronaldo. Strategu italian është i habitur se si nuk e ka fituar asnjëherë Ibra "Topin e Artë". "Po flasim për një lojtar të cilit çuditërisht nuk i kanë dhënë kurrë 'Topin e Artë'. Ka fituar 11-12 kampionate radhazi e askush nuk ka bërë diferencën në fushë më shumë se ai. Ende nuk e kam kuptuar përse e vendosin një shkallë më poshtë se Ronaldo apo Messi. Zlatani ka ndryshuar ekuilibrat e çdo skuadre ku ka qenë, pikërisht si portugezi apo argjentinasi. Kampionatin e fitonte ekipi që e afronte e kjo nuk është rastësi. Kuqezinjtë e kanë Ibrën", ka thënë Zaccheroni.

### Simeone: Oblak është portieri më i mirë në botë

Trajneri i Atletico Madridit, Diego Simeone, e krahasoi portierin Jan Oblak me superyllin e Barcelonës, Lionel Messin, pas paraqitjes në fitoren e Atleticos kundër Liverpoolit. "Ne e kemi një portier që, pa asnjë dyshim, është më i mirë në botë. E kam thënë këtë gjë që një kohë të gjatë. Është njëjtë, sikur që Barcelona e ka Messin. Ai vendos ndeshje me aftësinë e tij për të nisur aksione të sulmit. Oblak i zgjidh problemet me pritjet e tij", ka thënë Simeone. "Llorente e solli një revolucion në ekip. Jam shumë i lumtur për skuadrën dhe klubin. Ishte një ndeshje historike kundër një kundërshtari të jashtëzakonshëm me intensitet të madh dhe në një stadium të bukur. Ata na bënë presion, por ne u mbajtëm fort, pa u larguar nga plani ynë dhe patëm sukses falë punës të të gjithëve. Më jep kënaqësi të madhe sepse, edhe pse duket e thjeshtë, nuk është e thjeshtë të fitojmë", ka shtuar Simeone.

### Kloppi: Nuk e kuptoj pse Atletico vetëm mbrohet

Liverpooli është eliminuar nga Liga e Kampionëve, derisa trajneri Jurgen Klopp e ka të vështirë t'i gjejë fjalët pas kësaj humbjeje befasuese, e cila e eliminoi nga Liga e Kampionëve. "E kam të vështirë ta shpjegoj këtë humbje. Gabimi ynë është që nuk shënuam dot golin e dytë pesë minuta më parë. Shënuam në shtesë dhe jo gjatë 90 minutave. Bëmë 90 minuta fantastike, ku djemtë luajtën futboll spektakolar. Është e vështirë t'i shpjegosh ata gola që pësuam ne, por janë gjëra që ndodhin në futboll dhe duhet që të shohim përpara. Goli i parë nuk ishte problem kryesor, i dyti po. Gjithçka që dukej se po e bënim natyrale në 90 minutat e para, filloi të vështirësohej akoma më shumë në të dytën. Krosimet nuk kishin të njëjtin kualitet si më parë. Këmbët e lojtarëve u rënduan dhe nuk po jepnin më të mirën në fushën e lojës. Ishim brilantë deri në atë çast, por më vonë patëm probleme. Jam shumë i kënaqur me performancën, sepse është e vështirë të luash ndaj një skuadre të tillë", ka thënë Kloppi. "Nuk arrij ta kuptoj pse Atletico bën një futboll të tillë. Ata kanë lojtarë me shumë kualitet dhe vendosin të luajnë në mbrojtje për të na goditur me kundërsulm. Ata mund të luajnë futboll të vërtetë, por nuk e bëjnë", ka shtuar Klopp.

PRISHTINA INTERNATIONAL AIRPORT
ADEM JASHARI
Limak KOSOVO

## Njoftim

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" -Limak Kosovo, njofton të gjithë qytetarët të cilët kanë udhëtuar përmes këtij aeroporti se nëse kanë humbur valixhet e tyre dhe akoma kanë raportin nga zyra e '*Lost and Found*' apo dokumente tjera që dëshmojnë një gjë të tillë, të lajmërohen në aeroport deri më datë **31 Mars 2020** për të vazhduar procedurat e identifikimit dhe tërheqjes së valixheve të tyre.

Valixhet të cilat kanë mbetur në aeroport më shumë se 6 muaj dhe nëse pronarët e tyre nuk lajmërohen deri në datë **31 Mars 2020**, atëherë këto valixhe do të jepen donacion Shoqatave Humanitare që ushtrojne veprimtaritë e tyre në Kosovë.

Për cdo të dhënë shtesë ju lutem të kontaktoni zyren e 'Lost and Found' në aeroport në numër të telefonit: **00383 49911193.**

Uniteti

Kompania Regjionale e Mbeturinave K.R.M. "Uniteti" SH.A . Mitrovicë

## NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURSIT

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti"Sh.A - Mitrovicë zgjatë afatin edhe për shtatë ditë kalendarike për aplikim të kandidatëve për pozitën :

**Recepsionist/e - Njësia Skenderaj ,** konkursi i shpallur me datë 24.02.2020 në gazetën ditore Epoka e Re.

Për arsye se nuk është arritur numri i duhur i aplikacioneve.

Afati i konkurimit vazhdohet prej datës 13.03.2020 deri me datë 19.03.2020

**Vërejtje**:Kandidatët që kanë aplikuar më herët në këtë pozitë të punës, nuk kanë nevojë të aplikojnë përsëri. Formularin zyrtar për aplikim dhe informata tjera shtesë mund ta gjeni në zyrën e Arkivës pranë K.R.M "Uniteti" Sh.A. - Mitrovicë

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Marbleks" Sh.p.k Mitrovicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit, organizojnë:

## DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për eksploatimin e gurit dekorativ në Rahovec.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 03.04.2020 në ora 11:00 në objektet e kompanisë "Green Power" sh.p.k. në fshatin Zatriq komuna e Rahovecit do të organizohet debat publik nga kompania "Marbleks" Sh.p.k Mitrovicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për eksploatimin e gurit dekorativ në Rahovec.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.




**Salloni i Depilimit 'Lume's Details' në Prishtinë kërkon një praktikante e cila pastaj mund të punësohet me pagesë nëse tregon rezultat të mirë gjatë kohës së praktikës.**

**Të interesuarat mund të paraqiten në këta numra kontaktues: 045681898 dhe 044900978**

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria – Vlada - Government*

*Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit*

*Ministarstvo Infrastrukture i Sredine-Ministry of Infrastructure and Environment*

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë**

**për Kushtet Ndërtimore**

**"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Nr. prot: **7114/19** të datës **06.12.2019**, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**
Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
Ndërtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:
http://mia-rks.org/
Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:
Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
Suzana.goranci@rks-gov.net
Telefon: + 381 38 200 32 553

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria – Vlada - Government*

*Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit*
*Ministarstvo Infrastrukture i Sredine*
*Ministry of Infrastructure and Environment*

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë**

**për Kushtet Ndërtimore**

**"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Nr. prot: **6003/19** të datës **07.10.2019**, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**
Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
Ndërtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:
http://mia-rks.org/
Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:
Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
Suzana.goranci@rks-gov.net
Telefon: + 381 38 200 32 553

D.P.T "Vëllezërit Hoxha" Milaim Likaj shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr: 811015008 me seli në Runik.

D.P.T "Pesë vëllezërit" Mitrovicë shpall te pavlefshem nb: 70132128 dhe nr: fis 600551891.






## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Shqiponja Ibra shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së meseme "Xhevdet Doda" Prishtinë.

▶ Fahredin Duraku shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Bajram Curi " Krushë e Madhe.

▶ Skender Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Mustafa Bakiu " Prizren.

▶ Dibran Sope shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf " Dëshmorët e Zhurit " Zhur.

▶ Dreni Dorambari shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Arton Regja shpall të pavlefshme dëftesat shmlt "11 Marsi " Prizren .

▶ Luan Elezkurtaj shpall të pavlefshme dëftesat shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Ramiz Aliaj shpall të pavlefshme certifikatën dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Rahim Rafshi shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Arian Kryeziu shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Jemin kryeziu shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Hamit Hoxha shpall të pavlefshme certifikatën shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Sinan Nerjovaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Pjeter Budi " Lubizhd e Hasit " Has.
Nysret Gavazaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Dëshmorët e Zhurit " Zhur.

▶ Granit Kabashi shpall të pavlefshme diplomën shmlt " 11 Marsi " Prizren

▶ Fllanza Bislimaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Naim Frasheri " Kobaje.

▶ Bujar Shala shpall të pavlefshme dëftesat e shm " 11 Marsi " Prizren.

▶ Agon Vehapi shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

▶ Riza Likaj shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Sali Loshi shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Flora Zekaj shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Elbasan Buduri shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Shaban Musliu, shpall të pavlefshme dëftesën e vitit të –I- të shkollës së mesme teknike "Arkitekt Sinani" në Mitrovicë.




Në prag të 5, 6, 7 dhe 8 Marsit ditëve të lavdisë dhe sakrificës së familjes Jasharaj, ditës së mësuesit dhe ditës së nënës, për kandidat/etë interesuar për regjistrim të marrjes së patentë shoferit ofroj lehtësim financiar. **Vijimi i orëve praktike dhe teorike për 20 ore nga 200.00 Euro në 150.00 Euro.**

**Interesimi i juaj - përkushtimi ynë. Eksperienca jonë - suksesi i juaj. Afati i paraqitjes prej 02.03. 2020 deri më 20.03.2020**

